

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

BJH-32  
T 95



HILMI TUKAJ

NATA E PARE  
NEN UJE

tregime

814-32  
T95

HILMI TUKAJ

# NATA E PARË NËN UJË

*Tregime*



3236

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

## SHOKËT

Atë që kishte humbur shumë gjak, e shtrinë në tryezën e transfuzionit. Fytyrën e kishte të verdhë. Vetullat qimedjegura i qenë bërë si një lëmsh i vogël, i hirtë mbi sytë. Të tjerët u ulën në stolat prej meshini të bardhë në paradhomën e sallës së operacionit. Përsëri heshtje, ashtu si gjatë gjithë rrugës nga porti deri në spital. Kushedi sa rrugë kishin bërë pa folur këta burra të menduar, që sollën shokun e tyre të plagosur që kishte humbur shumë gjak. Ishte mëngjes. Në mëngjes zakonisht njerëzit dhe qytetet gjallërohen. Po detarëve që udhëtuan me të sëmurin, s'u bëri asnjë përshtypje qyteti i madh dhe i panjohur. Ndërtesat, sheshet dhe udhët kalonin në dritëhije, pa mundur të merrnin forma konkrete. Vetëm sytë, si ca diej të vegjël s'i shqitën për asnjë çast prej fytyrës së zverdhur të shokut të tyre.

Tani ishin ulur te stoli i bardhë prej meshini. «Shoku, që u plagos rëndë në hambar, duhet shpëtuar dhe ne të tjerët do t'i japim gjak, gjak të ngrohtë, do t'i japim jetë».

Këto mendime u vërtiteshin në kokë të gjithëve. Bota përreth ishte e huaj. Njerëzit, si ca copëza horizontesh të largëta, ishin krejt të huaj dhe të ftohtë. Detarët pritën të dilte mjeku. Lëvizjet e tij brenda në dhomën ku



futën të plagosurin, shquheshin nëpërmjet xhamit të derës. U ngritën të gjithë në këmbë, kur panë derën që u hap. I huaji nuk foli fare. Kishte sy të mëdhenj dhe të menduar. Në duar mbante akoma dorezat prej llastiku, me të cilat kishte bërë vizitën. Bocmani i vaporit, një burrë rreth të dyzetave, i foli në gjuhën e tij:

— Kemi ardhur t'i japim gjak të plagosurit. Të gjithë ne. Të filloj unë i pari.

— E di. Kështu më thanë. Do të bëjmë analizat dhe të përcaktojmë grupet, — tha mjeku, dhe si qëndroi një çast pa folur me sytë mbërthyer mbi fytyrën e bocmanit, u përmend e u fut përsëri në sallë. Figura e tij e plotë filloi rishtë të dukej si një hije që lëvizte pas xhamash.

Detarët e tjerë, ndonëse kuptonin shumë pak nga gjuha e të huajit, e morën vesh se çfarë tha ai, sepse mjeku fjalët i shoqëroi me gjeste.

Filluan analizat. Grupi i gjakut të detarit të plagosur u kombinua me gjakun e bocmanit dhe të katër detarëve të tjerë. Dhe përfundimisht ata që do të jepnin gjak, qëndruan në dhomën përballë. Qazimi dhe Xhelili dolën në korridor dhe zunë vend përsëri te stoli prej meshini të bardhë. Të dy detarët ndiheshin të shqetësuar. U dukej se kishin mbetur jashtë llogores, ku luftonin të tjerët. Sytë ia kishin ngulur derës me xhama, ku qenë shokët. «Atje brenda ndodhet kufiri i jetës», — i shkrepiti në kokë Qazimit. «Sa po vonohen dhe këta». Qazimi ktheu kokën dhe vështroi shokun, edhe ky po e shihte. Vështrimet u kryqëzuan. Të dy ishin të skuqur.

Ndienin zagushi, sikur u vinte të nxehtit nga brenda. Sikur po digjeshin.

— Sa po vonohen, — tha i pari Xhelili.

— Shumë, — u përgjigj tjetri shkurt, se mendjen e kishte te salla përballë.



Dhe ja, te dera afrohet një hije. Kur u hap, ata panë shokët me mëngë të përvjelura.

— E dhamë, — tha njëri prej tyre.

Xhemilit dhe Qazimit u jehuan në vesh fjalët e atij që foli, iu duk sikur njoftuan nga llëgorja lajmin e fitores.

— S'u vonuam?! — foli bocmani që e kuptoi gjendjen e shokëve. Ai i njihte mirë detarët dhe e dinte sa shumë e donin shoku-shokun.

— Jo... ishte vështirë?... — Në të vërtetë Qazimi nuk deshi të thoshte këtë, po «sa të lumtur jeni!»

— Jo, ore. Po s'dimë si po bëhet Sokoli.

Sokol quhej i plagosuri. I kishte rrjedhur shumë gjak, si një burim i vërtetë, aq sa mund të rrezikohej jeta. Patjetër duhej që gjaku i tyre të ruante atë jetë të bardhë. Erdhën të gjithë, sa akustuan vaporin në molo, që të ruhej jeta e shokut, ashtu si sulmuan të gjithë së bashku zjarrin në hambar, që të shpëtonin vaporin.

Sokoli që hedhur i pari në atë zjarr. I pari ndezi pompat e ujit dhe dha alarmin. Një hidrocentral i tërë malor është ngarkuar në vaporin e tyre. Shumë turbina, gjeneratorë, izolatorë të bardhë dhe aparate treguese. Është hera e parë që kanë për ngarkesë një hidrocentral. Një det të tërë me drita dhe zbardhëllim. Në mal dhe në fushë, njerëzit do të ndiznin dritat në shtëpitë e tyre, kudo qofshin, dhe ndoshta s'do të mendonin se këto i solli nga larg një ekuipazh që luftoi me zjarrin. Sokoli, për të mos vonuar ndezjen e dritave, u hodh dhe zuri me gjoks vrimën prej ku dilte zjarri që u ndez nga rrufeja. Hekuri i çarë aty preku koskën e kraharorit dhe u lye me gjak, me gjak të kuq.

Dera e sallës së operacionit u hap e tëra dhe prej an-

dej, mbi një barrelë me rrota doli i sëmuri. U shty në thellësi të korridorit dhe fytyra e tij e verdhë, e verdhë kishte mbetur. Sytë vazhdonte t'i mbante të mbyllur, megjithatë ata e dinin se brenda tyre lëvrinte një shkëndijë e bardhë jete, e pafuqishme, por e pashuar. Ata të gjithë njëherësh brofën në këmbë. U theri fort në zemër pamja e dobët e shokut të tyre. «Ai nuk mund të vdesë. Ne jemi të gjallë». Ky mendim sikur u dha forcë.

Bocmanit i qenë skuqur sytë. Ata flisnin qartë për gjendjen shpirtore të tij. Kur i qeshnin, punët venin mirë në anije. Kur i egërsoheshin, diçka çalonte. Tani sytë e tij të skuqur shprehnin tjetër gjë, që detarët nuk e përcaktonin dot. Ndoshta shprehnin dhimbje. Dhimbje! Ata i dhuruan gjak. Bënë ç'mundën. Natyrisht, po të mund të bënin më shumë, ata nuk do të ngurronin. Kjo dihej. Tani trupi i Sokolit u bë i tyre.

Nga dera që doli shoku i tyre, doli dhe mjeku. Ai qëndroi me këmbë të hapura para detarëve. Për një çast u bë një shtrirje shikimesh si mbi një horizont të ndezur. Sytë e mëdhenj të mjekut kishin përsëri diçka të pashpjegueshme dhe nuk e shprehnin dot atë që kërkonin detarët. Bocmani i zgjati paqetën me cigare «Durrësi» dhe ia ndezi. Iu drodh buza, kur e pyeti të huajin:

— Si është tani, doktor?

Mjeku lëshoi një fjollë tymi, dhe për herë të parë vuri buzën në gaz.

— Rrezikun e jetës e ka!oi. Kishte humbur shumë gjak. Ma merr mendja se pas dy javësh do të udhëtojë me ju.

Bocmani në fillim u step i habitur, pastaj një dritë, një ndjenjë gëzimi i zotëroi fytyrën. Nuk foli. Vetëm kur ndjeu nga shoku që kishte pranë një të goditur me bërryl, tha:



— Do të vijnë ta marrim pas dy javësh të shëruar!

Të gjithë si të çliruar nga një barrë e rëndë filluan të gjallëroheshin, madje të bënin dhe pak zhurmë në sallën e atij spitali të huaj. Edhe Qazimi me Xhelilin u gjallëruan. Bota që i rrethonte iu duk rishtazi e madhe dhe e pafund, si gjerësia e kaltër e detit. Në fillim mjekun e mësuar me qetësinë e përhershme të spitalit, e çuditi zhurma e detarëve, po pastaj edhe ai sikur u gjallërua. E rrëmbeu ndoshta gëzimi që kishte ndezur fytyrat e rrahura nga era të detarëve.

— Cigare e mirë! — foli papritur.

Këtë fjalë e morën vesh të gjithë pa pasur nevojë për përkthimin e bocmanit.

— Shumë mirë. Na, merre këtë paqetë shqiptare. «Cigarette Taraboshi».

— Taraboshi? Hëm.. aromatike?

Qeshën. Papritur mjeku i përqëndroi sytë e mëdhenj te bocmani.

— Desha t'ju pyes, ç'ishte nevoja të vinit të gjithë për të dhënë gjak?

Detarët kërkuan nga përkthyesi t'u thoshte çfarë tha i huaji. Bocmani i përktheu fjalët e mjekut, po vetë s'po dinte si t'i përgjigjej. «A mund ta kuptojë, vallë, ai dashurinë tonë për shokun, për solidaritetin tonë. A e kupton ai se jeta e shokut është jeta jonë? Ai me siguri nuk mund ta kuptojë hidhërimin e Qazimit dhe të Xhelilit që s'e kishin grupin e gjakut të njejtë me atë të shokut të tij».

Sytë e mjekut prisnin përgjigje. Atëherë bocmani tha:

— Ne s'do ta linim shokun tonë në asnjë mënyrë të vdiste. A e kuptoni këtë?!



Mjeku lëvizi sytë e mëdhenj e nuk tha asgjë. Nga ata iku ai vështrim pyetës, ndonëse detarët ishin të bindur që mjeku ende s'kishte mundur të kuptonte gjithçka. Detarët i shtrënguan dorën me radhë të huajit. Bocmani mbylli i fundit derën e sallës. Detarët, duke bërë zhurmë dhe të gjallëruar, hipën në tramvaj të gëzuar se shoku do të kthehej përsëri tek ata.

## ZËRI I ATDHEUT

Vapori ynë lundron mes dallgëve të detit të egërsuar nga cikloni. Ai çan përpara, po mbi kuvertën e tij është ulur këmbëkryq cikloni. Detarët, pasi siguruan pjesët e lëvizshme dhe mbyllën mirë bakaportët, zunë vend pranë iluminatorëve që ngjajnë si ca sy të mëdhenj dhe të bardhë. Në dhomë hyn kapiteni.

— Cikloni i fortë! — tha Hakiu, motoristi i dytë i vaporit.

— Po, — u përgjigj kapiteni.

Kapiteni ishte rritur në det. Ai e njihte botën përmes vështrimit të kthjellët që ka ajri i detit. I pëlqente të shihte fytyra të rreshkura nga dielli, të nxira nga jodi, njerëz të gjallë, me shpatulla të gjera që lëkunden si valët, njerëz të sakrificës e zemërbardhë. Ja, shokët që kishte përpara, ishin të gjithë të tillë. Me këta njerëz kapiteni kishte kaluar një pjesë të madhe të jetës së tij. Ai pa me kujdes deri ku cikloni i rrezikshëm që futur në ndërgjegjjen e detarëve. Po vështrimet e tyre flisnin për një qetësi të zakonshme. Qetësi!

Kapiteni u mat të largohej. Mendimi me të cilin kishte ardhur deri këtu, u zbeh nga shikimet plot guxim dhe dashamirësi të shokëve. Po kur hapi bakaportën, shikoi se nata kishte nisur të trokiste larg, përtej kolonave të ujit, dhe u kthye përsëri e thirri radistin.



— Javer!

Javeri, një djalë shpatullgjerë rreth njëzetetrevjeç, u ngrit në këmbë. Ia qepi sytë fytyrës së rrumbullakët të kapitenit.

— Urdhëroni, shoku kapiten!

— Të flisnim me qendrën. Duhet t'u themi atyre se ku gjendemi, — tha ai buzagaz.

Kapiteni dhe Javeri shkuan në kabinën e radistit. Grahma e helikave në kaldajë vinte nga thellësia si një zhaurimë ngjethëse. Dallgët e larta binin mbi bordin e vaporit, thua se donin ta përpinin.

Radisti ia nguli sytë e kaltër fytyrës së eprorit. «S'janë mirë punët», — mendoi, kur dalloi një nerv të vogël që i dridhej poshtë syve kapitenit. Kapiteni e vuri re vështrimin e djaloshit energjik dhe i buzëqeshi.

— S'është e para herë që anija jonë kalon një stuhi të tillë. Po do të mësohesh.

Radisti e kuptoi se kapiteni i tha ato fjalë sa për ta qetësuar. Vërtetë për të qenë udhëtimet e para dhe hera e parë që shihte një stuhi të tillë në det.

Javeri hapi radion. Vuri kufjet në vesh, për të mbuluar trubullimin që ndjeu.

— Hyr në valën e tyre! Kërko!

Javeri regjistroi frekuencën. Bëri gati taston. Kur po kontrollonte dhe një herë aparaturën, vuri re se llampa nuk ndizej. Kishte difekt antena. «Tërë kjo furtunë!» — mendoi Javeri. Qe shkëputur antena. Difekti dihej se ku ishte: jashtë, në ciklon, mbi kuvertë, nën kolonat e ujit.

Javeri kafshoi buzën e poshtme.

— S'kemi ç'të bëjmë. Difekt nga cikloni. Mbylle radion! — tha kapiteni dhe iku në korridorin e thellë. Javeri e ndoqi me sy, derisa trupi i bëshëm i tij hyri në kabinën e timonierit. Ç'të bënte? Mbylli radion. Pastaj do-



li në korridor. Iu afrua një dere që të nxirrte në kuvertë. Nga brenda dëgjonte si përplasej shtrëngata me forcë mbi hekur. Lëkundej vapori dhe shfrynte si në ethe... Mendoi se, kur të zbriste poshtë, shokët do ta pyesnin: «Ç'tha Atdheu?». Javeri do t'u thoshte se ishte këputur antena. Kaq. Preku dorezën e ftohtë të portës. Kjo natë po vinte ndryshe nga netët e tjera. Shtrëngata jashtë ulërinte.

Doli. Në anije hyri me furi cikloni. Derdheshin kolonat e ujit. Ai ndjeu se një kolonë e tillë u shkarkua mbi të. U mbajt te hekuri i bordit. U nis përsëri. Gjeti shkallën ku do të hipte në direk. Në direk, tani?! Si mbi gravitetin e botës ujore. Deti shkumbëzonte plot zemërim. Javeri u mbajt më fort te hekuri i lagur. Poshtë, nën kuvertë, shokët lexonin, bisedonin e bënë shaka me njëri-tjetrin. Larg, Atdheu priste sinjalet.

Filloi të ngjiste shkallët e direktut. Filluan t'i merreshin mendtë. «S'duhet të shoh poshtë». Tufani ia zbrëtheu peliçen prej meshini e në kraharor i hyri shtrëngata. Filloi të numëronte shkallët; nga poshtë vinte e tmerrshme kënga e stuhisë.

«Edhe pak», — i tha vetes. Teli varej poshtë si një gjarpër. — «Edhe pak». Deti poshtë që mbushur me hone të vogla si kratere vullkani. Javeri u ngjit dhe disa shkallë. Mbahej fort në hekur, aq sa gishtërinjtë nuk e ndienin më të ftohtët. Më në fund u ngjit. Me njerën dorë u mbajt, tjetrën e shtriu, po, në çastin kur dora i preku antenën, rrëshqiti... Krateret e zeza poshtë iu përfytyruan si oxhakë të nxirë nga bloza. Kolona e ujit i ra në fytyrë...

Kishte rrëshqitur nga shkalla dhe kishte rënë disa këmbë poshtë. Krahu i qe ngatërruar diku dhe s'e kishte lënë të fluturonte në prehrin e honeve. Si e mblodhi

veten, pa antenën të lëkundej përsëri si gjarpër. Nata po afrohej. Atëherë i dha edhe një herë trupit. Kur hipi në majë të direktut, iu bë se shkeli me këmbë ciklonin. Antena i varej fare afër. E kapi fijen e saj dhe e vendosi te vida nga kishte dalë. E shtrëngoi fort. Antena tani nuk lëkundej më. Ai u ul në vend dhe pushoi pak. Në qafë ndjeu një të ngrohtë që e përqethi. Vuri dorën dhe pa gjak. Ishte plagosur. Furtuna i pruri në vesh emrin e tij. Mendoj se i bënë veshët, sepse nuk e dalloj kapitenin që po ngjiste shkallët e direktut në drejtim të tij:

— Javer, Javer!

\* \* \*

Pas pak Javeri i mjekuar dhe i lidhur me fasho, i jepte sinjale Atdheut. Shokët genë mbledhur në kabinën e radios.

Dora e kapitenit përkëdheli flokët e verdhë të radistit. Cikloni, para iluminatorëve, po hiqej zvarë si një bollë e plagosur.



## T A B A N I

Natën tunelistët e portalit kërkonin të gjenin tabanin e malit.

Gjithë ditën guri i bardhë tregoi damarë që e këpusnin fillin dhe që humbisnin në zemrën e shkëmbinjve të padukshëm. Fantazia e minatorëve u zbeh disa herë, por u rrit këmbëngulja. Mendimet e tyre depërtuan përmes damarëve dhe pluhurit të bardhë, tutje, ku duhej të ishte tabani.

Dalngadalë mbrëmja po nderej mbi mal. Një pjesë e minatorëve menduan se po punonin fare kot, të tjerët kishin humbur me kohë në zhurmën e njëtrajtshme të martelit. Ndienin dhembje në shpatulla, por s'donin t'ia dinin, donin të gjenin patjetër tabanin e këtij portali.

Kur ndienin lodhje e ndërprisnin punën dhe të heshtur shikonin tymin që ngrihej nga marteli, fshinin djersët dhe përsëri shtrëngonin trupin pas tij. Hysniu dëgjoi ta thërrisnin. Kishte ulur martelin dhe po pushonte, ndryshe s'do të kishte dëgjuar.

— Hë, more, ku je futur dhe ti, — i foli postieri. Postierit iu drodhën buzët, kur nisi t'i fliste minatorit. Hysniu u drodh, një e përqethur i përshkoi trupin. — Hajde, hajde, se u bëre me djalë. — I bënin veshët apo qenë të vërteta ato fjalë? Sytë e Hysniut u ndezën. Dri-



ta e tyre ra në fytyrën e lodhur të postierit si të kishte rënë një rreze dielli nga diku larg. Ishte aq i gëzuar, sa nuk e ndiente peshën e rëndë të pistoletës që e kishte mbështetur mbi këmbën e djathtë. Nuk i besohej. Shikonte postierin dhe mendohej të kuptonte nga fytyra e tij nëse e kishte seriozisht. «Një jetë e re i ishte shtuar shtëpisë së tij».

— Si, more? Vërtet thua!

Postierin e hutoi dyshimi i minatorit. Madje, i fyer, ia lëshoi telegramin në dorë.

— Vëlla, urdhëro lexoje vetë. Shqip e ke telegramin. Kungull! Pse, kot erdha nëpër natë deri këtu, — dhe heshti.

Hysniu nuk priti më, por e rroku në krahë lajmësin. E tundi dhe e shkundi atë si pendë.

— Lëshomë! Lëshomë! — thoshte postieri. — Unë nuk jam pistoletë, — qeshi ai, dhe s'i mbajti inat minatorit. Postieri e njihte minatorin, prandaj dhe e justifikoi hutimin e tij. Hysniu atë çast ishte njeriu më i lumtur. Aq i lumtur sa nuk mund ta besonte! Tani po mendonte për emrin e foshnjes. Emri i të birit duhej të thoshte diçka për jetën e tij Si... Gëzim... Shkëlqim... Shpëtim?! T'i mbesë Shpëtim. Ai ia shpëtoi ëndrrat. Njeriu pa ëndrra i ngjet një liqeni me ujë të amullt. Hysniun kurrë nuk e kishte tërhequr pas vetes amullia e jetës. Në punë ai ishte i fuqishëm dhe i papërtuar. Jetën e kishte rregulluar më së miri. Vetëm fëmija i duhej.

Dhe ja, sonte pas dhjetë vjet martese, ishte shtuar me djalë! E gjithë brigada e dinte se Hysniu nuk kishte fëmijë, dhe u vinte keq për të që bënte aq shumë mbas fëmijëve.

— Ti më dhe një lajm të gëzuar sa s'ka më, që unë...

— Lëri llafet, po merr lejë se kam ndaluar makinën e zhavorrit, atje poshtë për ty.

I gjithë kantieri ziente. Martelët sipër kokave të tunelistëve, çonin peshë shtëllunga tymi e pluhuri. Biga e vinçit që qëndronte në portal, lëvizte si një gjymtyrë e kujdesshme. Drini zhurmonte. Shumë larg shirat e kishin fryrë lumin. Lugina e Fierzës dukej si një hambar i ujërave të largëta. Lagështira e mbrëmjes ia freskonte ballin Hysniut. Megjithëse dritat ia pulitën sytë, ai përpiqej të përfytyronte gruan, gëzimin e saj. Tani kushedi se si i qeshte fytyra. Tërë përpjekjet e tyre për një fëmijë u bënë realitet. Mori frymë thellë dhe drejtoi shpatullat e gjera.

— Nuk kanë shpërblim fjalët e tua, vëlla! Kur e more telegramin?

— Ja, tani. Nxitova të ta sillja

— Si të ta shpërblej nuk e di. Ti je njeri i mirë.

— Keni filluar kanalin e devijimit kështu?

— Po. Sonte do të nxjerrim patjetër tabanin në portal. Pastaj puna ecën me makinën e shpimit. Nesër do të bëhet hapi i parë për hapjen e tunelit. Janë male të reja. Tabani nuk është i mirë.

— Hë, do t'i marrësh lejë brigadierit të vish, apo nuk është e nevojshme. . .

— Për çfarë, ore Gani, t'i marr lejë brigadierit?

— Hë, pra, se po pret dhe shoferi atje poshtë.

Minatori lëvizi nga vendi. Duhet të vrapoj dhe unë. Nuk është turp. Një jetë e re, e dalë nga jeta e tij e madhe duhej pritur me krahë hapur.

— Nisemi! Brigadieri nuk më mban po t'i them se më ka lindur gruaja.

As kur kishte qenë i ri nuk kishte ecur kaq shpejt. Por nuk bëri as pesë metra dhe qëndroi. Pas tij nuk bëri



hap as Ganiu. Ky i fundit, me një shikim therës, që e shigjetoj mikun e tij në sy, tha:

— Përse qëndrove?

Për një çast iu bë se shkeli me hapin e tij të rëndë kaskat e shokëve që ishin poshtë në portal. Ai kishte qenë i pari që kishte ngulur këmbë të gjenin atë natë gjurmët e damarëve të shkëmbit të padukshëm, ndërsa tani po ikte. «Kjo nuk është e ndershme, — mendoj ai. — Nuk është as e bukur. Dhe s'ka si të jetë». Ai u mendua për një çast fare të shkurtër, shikoi postierin që priste i hutuar pas tij, iu duk sikur dëgjoi një zë të lehtë, që çuditërisht u ngjante të qarave të një foshnjeje të shumëpritur, zërin e gruas dhe të të afërme që, natyrisht, e prisnin me padurim. Pastaj drita e tunelit ra mbi të gjitha këto dhe ai e ndjeu se kjo heshtje e rënë kaq befas dhe ky ndalim i papritur sigurisht që kishin lidhje me botën e tij të madhe.

— Nëse e gjejmë tabanin sonte, nisem nesër në mëngjes për në shtëpi, — vendosi më në fund Hysniu. — Ndërsa ti, — iu kthye postierit, — po deshe bëmë një nder tjetër. Bëju atyre të shtëpisë dhe Selvijes, në shtëpinë e lindjes, nga një telegram nga ana ime. Si u mendua pak, pyeti postierin që po rrinte si i hutuar.

— Hë, si thua, do të ma bësh këtë nder, — dhe u ul e mori martelin që e kishte shtrirë përtokë. Valvola e ajrit fishkëlleu dhe zhurma e thatë ia tulari mendimet që i zienin në mendje.

Të gjitha këto i tha me një frymë, si për të larguar atë valë të nxehtë që i digjte përbrenda. Shkëmbi ishte i fortë. Dukej se në atë shkëmb periudhat gjeologjike sapo kishin nisur pikën e formimit. Baromina ngecte gjithnjë. Ajri ngrihej shtëllungë. Ganiut i hipi inati me mikun e tij.



— Ti nuk qenke njeri! — filloi t'i shfrynte postieri, — më dëgjon? Nuk je në vete. S'e besoj se do të të nxjerrë pengesë brigada. Përkundrazi, ajo do të të nisë me zor. Kokëshkretë!

Hysniu, me muskuj të tendosur, e dëgjoi në qetësi Ganiun. «Vërtet brigada po ta marrë vesh do të të nisë patjetër». Të gjithë e dinin si bënte ai për fëmijët, si i përkëdhelte. Nganjëherë, kur takonte fëmijët e shokëve të brigadës, i përkëdhelte, i puthte me dhimbshuri dhe u blinte diçka të vogël. Shokët do ta nisnin. Ai e dinte këtë, por ai s'do të pranonte... Postieri ndërkaq kishte mbyllur valvolën e ajrit. U bë një farë qetësie aty rrotull dhe mund të dëgjohej biseda e tyre nga shokët përreth. Me pahir, Hysniu i buzëqeshi postierit dhe i foli me të butë:

— Gani, ç'hyn brigada këtu? Jemi të lidhur me punën. Sonte do të zbulohet tabani patjetër. Selvija të më falë. Ka shumë mundësi të shkoj nesër në shtëpi. Kur brigada jonë merr një vendim, nuk ka njeri që t'i shmanget. Selvija e di mirë këtë. Ajo do të më kuptojë dhe do të më falë. Le që nuk ka çfarë të më falë. Sidoqoftë ajo do të më kuptojë. Ti shko tani, se kemi penguar dhe shoferin. Mos u zemëro me mua. Je njeri me shpirt të gjerë. Të falem nderit. Besoj se do të ma kryesh porosinë. Ja, të gjithë nuk e çojnë kokën nga puna, ndërsa unë të largohem. S'janë llafe këto.

Kaq tha dhe bëri të kthehej për te vendi i punës sepse dëgjoi zëra minatorësh. Ishin një grumbull. Hysniut i dogji kraharori dhe hëngri buzën me dhëmbë. Shokët po e vështronin me sy të gëzuar dhe minatori e ndjeu veten edhe më ngushtë se radhën e parë. Ja, ata ishin nisur ngadalë tek ai. Qeshnin me zë të lartë dhe nga mënyra si i hidhnin hapat, dukej se ishin të gëzuar. Djer-



sët e mbuluan të tërin. Ata iu afruan dhe po i jepnin urimet e tyre. Ai i njihnte dhe i donte të gjithë.

— Të të rrojë djali, vëlla!

— Na gëzove zemrën!

— Ky është lajm! Sonte patjetër do ta gjejmë tabanin!

— U bëftë trim dhe punëtor si babai i tij! — foli më në fund brigadieri, më i vjetri në moshë në atë brigadë. Hysniu kishte mbetur si i tulatur. Po ua kthente urimet me gjysmë zëri shokëve. Ai e dinte se çfarë donin të thoshin këto urime të zjarrta dhe deshi t'ua priste hovin, po nuk e lejuan të hapte gojë.

— Hysni, erdhëm të të urojmë para se të nisesh. Çoja urimet tona dhe Selvijes, sepse dhe ajo është shoqja e brigadës sonë.

Megjithëse po i rrihnin tëmthata, minatori kishte vendosur të mos lëvizte nga e tija, sido që të bëhej. Ata, pas kaq vjet pune së bashku, nuk e paskan njohur si duhet. Ai do të mbahej në të tijën pa fjalë të tepërta. Atij nuk i kishin pëlqyer kurrë fjalët e shumta sepse, sipas tij, pas tyre fshihej varfëria e punës.

— Brigadier, unë nuk do të shkoj në shtëpi. Përse nuk punon brigada? Me të gjetur tabanin unë do të shkoj të shoh fytyrën e foshnjës sime. Kështu nuk bën të... jam gëzuar që ju më erdhët pranë... e shoh që ju të gjithë jeni gëzuar sa dhe unë. Ju falem nderit. Është prerë e gjithë puna këtu. Është prerë dhe ajri. Nuk e shikoni? E rregulloj unë, bre... — dhe u largua duke zbritur shkallët e dheut deri te kompresorët poshtë, buzë Drinit. Shpatullat e gjera i tundeshin si shpatullat e një detari. Dukej sikur fluturonte me ecjen e tij. Të tjerët buzëqeshnin të gëzuar. Postieri kishte mbetur i çuditur. Në lëvizjet e Hysniut gjithçka ishte e gëzuar. Brigada u kthye



në punë. Hysniu, që ishte kërrusur mbi lumë, rregulloi tubat e ajrit pa e ngritur kokën lart. Duart i dridheshin. E shqetësonte ndërkaq dhe një vegim që binte mbi ujin e lumit. Diçka që përsëri kishte lidhje me zërin e foshnjeve dhe të gruas. «Selvija do të më kuptojë drejt». Valët e lumit rrokulliseshin drejt detit. Mbas pak u ngrit. Përsëri me hap të nxituar shkoi te marteli. Të tjerët qenë nëpër vendet e punës. Dikush i tha që larg:

— Po e gjetëm sonte tabanin, nesër do të vijmë të gjithë te ti. Posa të lëmë punën, — dëgjoji ai zërin e shokëve dhe buzëqeshi.

Brigadieri, që ia kishte kuptuar mendimet, iu afrua me shumë kujdes dhe i foli ngadalë, si një miku të vjetër, që miqësinë e kanë lidhur prej vitesh kantierëve dhe tuneleve, kudo që kanë vajtur së bashku.

— Të lumtë, Hysni! Me njerëz si ti patjetër që do ta gjejmë tabanin.

Puna kishte përsëri ritmin e parë. Martelët shkatërronin gjithë damarët e gurëve dhe të shkëmbinjve të nëndheshëm. Përmes vrimave, thellësia e tokës vështron-te mëngjesin dhe fytyrat e djersitura dhe të bukura të tunelistëve.

## MJEGULLA

Ai që e vuri re injegullën, kur nisi të shtrohej si një masë e përhimtë mbi det, ishte detar Remziu, sepse mëngjesi e gjeti tek ura e komandës. Atë çast ai po bëhej gati ta linte shërbimin dhe të shkonte në kabinën e tij, kur pa përpjekjet e diellit përmes mjegullës së dendur që të ngrihej mbi det, si një lulëkuqe e spërkatur nga vesa e natës.

Në tubin folës dha raportin e fundit: «Shoku komandant, në drejtim të kursit tonë shtrihet me shpejtësi një mjegull e dendur. Mëngjesi nuk është i kthjellët». Ngriti me dorë flokët që i ranë mbi ballë. Iu bë se duke luajtur me ta, topitja e gjumit largohej. Kur la shërbimin, deti ishte i qetë. Erërat e jugut që patën fryrë natën, errësira i humbi, si t'i merrte në kurriz.

... Timonin e anijes e drejtonte mengadalë, me të dyja duart. Ishte gjë e bukur të shikoje detin nën dritën e hënës dhe llamburitjen e yjeve. Atë mbrëmje kishte menduar dhe i qe dukur se jeta e tij po merrte një kurs të ri, së bashku me udhën e vaporit. Mendonte për Liljanën, vajzën që donte, ndonëse asaj akoma nuk ia kishte thënë të gjitha. Ndoth dhe kështu. Ishte pak i druajtur në bisedat me të dhe, ndonëse këtë të metë ia njihte vetes, s'kishte gjetur forcë për ta ndrequr. Shkas për ëndrrat e



mbrëmshme u bë një ngjarje e jashtëzakonshme për ta. Në këtë udhëtim, në anijen e tyre erdhi një radiste e portit, në vend të radistit të sëmurë. Anila ishte shoqe me Liljanën, dhe gjithmonë bashkë i shihje. Anila kishte një shtat të hedhur dhe flokë të derdhur sùpeve. As dielli nuk kishte rreze më të ndezura se ngjyra e flokëve të saj. Në tërë ngjyrën e kaltër të detit, koka e Anilës dukej si një grumbull petalesh të veçuara, që i merr era dhe kudo të bien në sy...

Zbriti poshtë dhe hyri në dhomën e tij; përballë hyrjes ishte varur në mur një portret. Ajo pikturë tregonte një detar të vjetër që gjithnjë qeshte. Megjithëse portreti ishte një punim me vlerë, timonieri nuk e mbante mend se kush e kishte sjellë aty.

Kur po dilte nga kabina, u shikua dhe një herë në pasqyrë. I luajti syrin portretit dhe u nis për në mensë. Këto ditët e fundit sikur qe çelur e gjallëruar shumë. Detarët që e dinin paksa të mbyllur Remziun, e kishin vënë re këtë ndryshim dhe vrisnin mendjen të gjenin shkakun. Po e vërteta fshihej në kraharorin e detarit timonier dhe ai lloj gëzimi ishte shumë i dashur për të. Doli nga mensa duke kënduar nën zë.

Mjegulla e kishte errësuar pothuaj krejtësisht pamjen e detit. Në direkë ishin ndezur projektorët e verdhë të sinjaleve. Ai e dinte se tani vjeshta sillte herë pas here shtëllunga të zeza mjegulle. Dielli luhatej dhe çante si me shpatulla retë. Në fillim ndoqi përpjekjet e diellit, pastaj ia mori një kënge detarësh. Mjegulla në çast ia humbi zërin. Ishte një element i kundërt mjegulla me gjendjen e tij shpirtrore, ndaj nga inati filloi të këndonte dhe më fort. Mbaroi të parën dhe nisi të këndonte një këngë të dytë, po me zërin e tij u përzie dhe një zë i dytë. U kthye i çuditur. Drejt tij po vinte Anila, me atë buzëqeshjen e ëmbël si një trëndafil i çelur.

— Si jeni, Remzi? Ishit me shërbim dhe nuk u takuam.

I shtriu dorën e saj të vogël. Timonieri e shtrëngoi lehtë.

— Mirë jam.

— Ju këndonit ashtu?

Ai pohoi me kokë dhe si i turpëruar filloi të fliste:

— Ambienti këtu përreth nuk e përcjell zërin... nuk...

— Ju kënduakeni mirë. Zëri juaj tingëllon fort.

Ai qeshi, si të donte të thoshte: mos u tall. Ajo e hoqi shikimin në det.

— Sa keq! Mjegull sot!

Remziu u shpejtua të thoshte diçka më të matur, ndonëse mendjen e kishte te Lili. «Ah, sikur të kishte ardhur ajo në vend të Anilës. Këtu, po, do t'i thosha pa frikë të gjitha ç'ndiej për të».

— Sot duhej diell. Këto ditë qielli ka qenë gjithnjë i kthjellët.

— Pse duhej diell?

— Si të them? Është e padurueshme mjegulla. Në oqean nuk është kështu. I trishton paksa njerëzit kjo kohë.

— Mua jo.

— Varet nga njerëzit.

Ata heshtën. Kraharori i timonierit vlonte nga ndjenjat. Dallgët që trazojnë detin e fjetur lëviznin si ndjenjat e tij.

— Më thuaj diçka, Remzi!

— Çfarë të të them, — murmuriti detari, që diku tjetër e kishte mendjen.

— Nuk po më duket e vështirë jeta këtu në det, — tha ajo e ngutur mbasi nuk kishte veçse dy ditë në det.



-- Jo, nuk është e vështirë!

— Pse ma bënë të tmerrshme ata?

Pyetja hapi një dritare në botën e saj të brendshme.

Ai u ngroh nga toni i saj i butë.

— Kush janë ata, Anila?

— Babai dhe një mik i tij detar. Ma kanë bërë skëterrë jetën në anije. Ata nuk më kanë lënë deri tani të vij në anije. Edhe kësaj here pa pëlqimin e babait kam ardhur. Po unë dua të lundroj. Të kem edhe unë vendin që më takon. Ndryshe nuk do të mund të quhem detare.

— Në tokë nuk quhesh detare.

— Kështu është.

— Në det, po. Keni vendosur të qëndroni përgjithnjë?

— Kam vendosur.

— Mirë.

— Unë e dua shumë detin, — vazhdoi ajo. — Që fare e vogël, lozja me valët e tij. Do të mësohem... me dallgët.

— Mësohet njeriu.

— Jeni i bindur?

— Përse të mos jem i bindur?

— Sikur shprehin dyshim sytë e tu.

— Ju jeni një vajzë e guximshme.

Fytyra e Anilës shkëlqeu. Ky shkëlqim u shoqërua me një buzëqeshje të pastër dhe të çiltër.

Ajo po i fliste gjithnjë me tonin e parë.

— Shumë herë kemi folur bashkë në radio.

— Po, unë ju njihja nga zëri.

— Edhe unë. Si e keni mësuar radion?

— Kisha dëshirë të mësoja diçka tjetër...

— Profesionin e dytë...

— Si të them, diçka mësova nga tërë ato shenja dhe fjalë të alfabetit mors.

— Edhe unë do të mësoj të drejtoj anijen, — u hodh ajo si një fëmijë dhe i preku mëngën e krahut të djathtë.  
— Do të më mësoni ju?

— Po të keni dëshirë.

— Kam shumë dëshirë të bëhem detare e vërtetë, — dhe ia dha një së qeshure të çiltër. Flokët i ranë mbi fytyrë. I rregulloi shpejt dhe u mbështet mbi hekurin e bordit. U dëgjjuan hapa. Dikush po afrohej. Ishte bocmani i vaborit, një detar i vjetër i rrahur nga shtrëngata dhe dielli.

— Do të na nxjerrë punë kjo mjegull, — u foli të rinjve. Nuk iu përgjigj njeri. Plaku kërkoi diçka nëpër xhepa dhe pastaj hodhi vështrimin mbi fytyrën e Anilës.

— Radistja e re nuk paska pasur këmbë të mbarë në këtë vapor. Si thua, moj vajza e Kiços? — Pa pritur përgjigje vazhdoi të fliste përsëri. — Jeta nuk është dëshirë, jeta është luftë. Të të vijë keq për babanë.

Bocmani u largua. Horizonti ishte i nxirë. Ata mbe-tën për një çast vetëm. Pastaj dhe Anila u largua. I mbe-tur vetëm, nisi të mendonte për fjalët e bocmanit.

— Ç'bën Remzi, pse s'ke vajtur të flesh, — i foli kapiteni që kaloi pranë tij.

— S'më flihet.

— Sonte në mensë do të organizojmë një darkë të mirë. Duhet të jetë madhështore, më kupton? Ardhja e radistes në ekuipazhin tonë është një ngjarje me rëndësi. Është e para lule në det, apo jo?

— Po...

— Si herët e tjera, ti do të merresh me organizimin e darkës. — Dhe ngriti duart si për t'u dhënë rëndësi fjalëve. — A më kupton, Remzi, ajo është një vajzë e çuditshme, theu një koncept që i ka rrënjët të thella. Dhe iu desh shumë luftë. Ti je i ri në historikun e detarisë



shqiptare, por duhet ta dish se në varkat e ilirëve ka pasur gra që kanë udhëhequr lundrimin në det të hapur. I vështirë është fillimi, ja, kjo që bëri Anila, prandaj sonte do ta festojmë vendçe. Merru me organizimin e darkës. — I rrahu shpatullat. — Sot ka shumë mjegull. Vjen nga poli. Dimri po përgatitet të vijë me lagështirë. Më kupton, Remzi, të gjitha forcat shkriji. — Dhe u largua. Dukej tepër i gëzuar dhe shkallët i ngjiti si duke vrapuar.

«Në këtë darkë të bukur, duhet t'i bëjmë një surprizë Anilës. Ajo nuk i njeh njerëzit e detit, dashurinë e madhe të tyre për shokun». Duhej të takonte bocmanin, sepse ai ruante në magazinë materialet e zbukurimit të sallës, disqet e inçizimit dhe mbulesat e tavolinave. Pastaj kishte punë me kuzhinierët. U nis drejt kështjës të vaporet. Projektoret e verdhë dukeshin si ca sy gjigantë të tretur në ujë.

— O Remzi, o Remzi! — dëgjoi një zë prapa krahëve.

— Ty po të kërkoj, bocman.

— Përse?

— Të tërheq nga magazina materialet e zbukurimit të mensës. Sonte kemi festë.

Plaku u çudit.

— Festë? Pse, ç'ditë është sot?

— Ditë e rëndësishme. Festojmë ardhjen e radistes në vaporet tonë.

— Ashtu. Shumë mirë... Ti do ta organizosh?

— Po.

— Të shkon biseda me të, — qeshi më pas bocmani.

— Nuk e prisja nga ti këtë, bocman. Ne ishim të njohur. Bocman, ajo është vajzë trime. — Remziu e donte shumë bocmanin, ai ia kishte mësuar detarinë, por atë çast se si iu duk.

— Ehë, Remzi i dashur, ju të rinjtë jeni ndryshe. Dëgjo, ti duhet të organizosh një darkë ashtu siç i ka hije vaporit tonë. Për çdo anomali që mund të vërej, do të më mbetet qejfi. Të mos vonohemi. Bëra gabim që fola ashtu për Anilën, o Remzi. Anila çau përpara. Shkojmë.

Hynë në derën e parë të kuvertës. Bocmani ishte shumë i gëzuar.

Ngadalë-ngadalë dhe mjegulla në horizont po davaritej.



## NATA E PARË NËN UJË

Mbrëmja po shtrohej e qetë. Nëndetësja me numrin njëzet doli në sipërfaqe dhe prishi botën e ngjyrave. Trupi i saj gjigant doli me zhurmë, si të shkundte nga shpatullat gjithë ujërat e thellësisë. Përreth kishte shumë ishuj dhe mjegull. Në drejtim të lindjes, andej nga vijonte kursin nëndetësja, rrihte ajri i ftohtë i dimrit që po shtegtonte për në pol.

Kapiten Petriti, komandanti i nëndetësës, doli i pari mbi kuvertë. Ajri i ftohtë i përshkoi mushkëritë, sa e bëri të kollitej lehtë dhe e detyroi ta mbërthente më shumë xhakaventon prej lëkure. Pas tij dolën nga bakaporta qendrore dy detarë, timonieri dhe sinjalisti i anijes. Dhe ata u mbështollën mirë, zunë vend në postat e drejtimit dhe raportuan gatishmërinë. Komandanti nuk foli. Ai kishte mbërthyer vështrimin në ishujt e largët dhe diçka mendonte. Detarët të habitur vështruan njëri-tjetrin. Në orët e para të daljes në det, Petriti si zakonisht pyeti për kursin dhe të dhënat e kursit. Më vonë u mbyll në heshtjen e tij. Në mendjet e detarëve kishte zënë vend kureshtja dhe shqetësimi nga kjo heshtje e kapitenit. Ishin mësuar të bënin biseda të lira me të. Në det, detarët janë të lidhur shumë me njëri-tjetrin. Nga poshtë dëgjohej zhurma e rëndë e motorave. Mbrëmja shtrohej pa-

ra tyre si një mjegull e murme mbi një pllajë të largët. Ishujt mbetën në sfond si njolla diafilmash të djegur.

Në urën e komandimit u ndezën dritat e lundrimit. Mjegulla u ça nga projektorët dhe u duk se deti i gjerë mori jetë nga frymëmarrja e nëndetëses dhe nga këto drita të forta.

Komandanti u mbrojt më mirë nga cra dhe foli pa pritmas:

— Ftohtë!

Dy detarët vështruan njëri-tjetrin. Dikush duhej t'i përgjigjej. Foli sinjalisti:

— Megjithëse jemi në të dalë të dimrit. Në këto vende pranvera vjen shpejt. Te ne duhet akoma dhe një muaj.

Komandanti s'e zgjati. Marinarët shkëmbyen një shikim mes tyre. Detarët ky qëndrim i shqetësonte, ndaj detari timonier, që ishte një vit më i madh se sinjalisti, e prishi heshtjen.

— Shoku komandant, ju diçka mendoni dhe mundoheni të na e fshihni neve. Më kujtohet dita e parë e lundrimit, kur ju na thatë se kur dilni nga thellësia e detit keni qejf të bëni dy para muhabet. Në të vërtetë kjo ura e komandës na është bërë si vendi i bisedave.

— Po, — tha Petriti, — keni të drejtë. E dini ç'po mendoja? Sonte, — vazhdoi ai, — pasi të zhytemi në det, në thellësinë tridhjetë metra, skuadra e punimeve nën ujë do të kryejë veprime imituese. Kjo është detyra e këtij lundrimi. Mirëpo po mendohesha, se nuk i kam studjuar punët si duhet. Në ekuipazhin tonë dhe në skuadrën e punimeve nën ujë kemi detarë të rinj që...

Detarët e kuptuan se çfarë do të thoshte kapiteni. «Në këtë detyrë të vështirë duhet eksperiencë dhe shkahtësi. T'i zhytësh detarët për t'i provuar, do të thotë të



ecësh mbi paterica dhe jo mbi këmbët e tua». Të tre heshtën. Komandanti u foli përsëri.

— Shokët e tjerë janë gati të zhyten, ndërsa Qemali, jo.

Qemali ishte motoristi i anijes dhe detari më i ri. Ai nuk kishte as dy muaj që kishte ardhur në këtë nëndetëse. Që në ditët e para Qemali i ishte përveshur mësimt të anijes dhe lundrimit në det të hapur. Kishte treguar kujdes dhe u njoh me të shumë shpejt, madje ardhja e tij i shtoi një notë gazi ekuipazhit. Ai dinte të këndonte dhe të luante me fisarmonikë. Kështu që i hyri në zemër tërë ekuipazhit që në fillim. Dhe komandanti e komisari e mbanin pranë. Bile komandanti kishte zbuluar tek ai djalosh një farë dashurie për detin. Mirëpo s'e paskësh njohur tamam. Sot, pikërisht sot ai kishte dalluar një hije frike që e kishte bërë Qemalin të tërhiqej nga shokët.

«Nuk ma mban të zhytem», — i kishte thënë ai komandantit kur ky i kishte thënë detyrën. Mirëpo Petriti kishte ngulur këmbë dhe i kishte dhënë urdhër të zhytej.

Ja këto u tregoi komandanti detarëve pranë urës së komandës. Ishin çastet para zhytjes dhe ai ndihej tepër i emocionuar.

Petriti për një çast vështroi detin që ishte tretur i tëri në errësirë po pastaj qe kthyer nga timonieri e i kishte zgjatur paqetën e cigareve.

— Na, ndizeni nga një.

Të tre vunë buzën në gaz dhe ndezën nga një.

— S'e di a veprova mirë, po nuk më pëlqeu frika e Qemalit, ndaj këmbëngula të dilte në det, — tha komandanti që vazhdonte ta kishte mendjen po atje.

— Keni bërë shumë mirë, komandant. Të gjithë në

fillim kemi pasur pak frikë po pastaj e kemi parë sa gjë e bukur është zhytja. Edhe Qemali do t'ju falënderojë më vonë.

Petriti deshi të thithte cigaren por ajo qe shuar. U përpoq ta ndizte po Saliu foli duke qeshur:

— Shoku komandant, bota ecën përpara, urdhëro! — dhe i shtriu paqetën me duhan «Taraboshi».

— Nga e more?

— Nga e fejuara. Kishte ditëlindjen dhe më qerasi me paqetë.

Ia plasën gazit përsëri. Nëndetësja ecte me vrull. Petriti tani erdhi në qejf.

— Në cilin kurs jemi?

— 29 gradë, verilindje, — u përgjigj timonieri.

— Tani duhet të zhytemi, — dhe bëri një lëvizje të shpejtë të dorës, ashtu si e kishte zakon kur pregatishte nëndetësen për zhytje në thellësi.

Ashtu si doli me zhurmë, me poteren e valëve që i nënshtronte me peshën e trupit të saj, anija u zhyt përsëri. La sipër gjësimin e valëve dhe errësirën e dendur.

\*  
\*       \*  
\*

Skuadra e punimeve nën ujë u rreshtua në lokalin qendror. Të gjithë ishin të pajisur me mjetet e punës dhe prisnin urdhrin e komandës. Thellësia kishte arritur tri-dhjetë metra. Nën këtë presion janë të mundshme veprimet nën ujë. Saliu qëndronte në krye të rreshtit dhe vazhdimisht e këshillonte Qemalin për funksionimin e aparatit.

Kur hyri komandanti në lokal të gjithë u ngritën në këmbë. Komisari ua bëri me dorë detarëve të uleshin.



Ata u ulën në formë rrethi dhe vunë kapitenin në mes. Petriti i shikoi të gjithë me radhë dhe në fillim ndeshi shikimin e tretur të Qemalit, pastaj dalloi vështrimin e detarëve të tjerë që shprehnin gatishmëri. Iu drejtua mekanikut:

— Shemsi, i keni kontrolluar me kujdes kostumet e polumbarëve?

— Po, — iu përgjigj mekaniku, — janë krejtësisht të rregullta.

Petriti u buzëqeshi për t'u hequr dhe atë pak emociion që të kap në të tilla raste. Padyshim bota e nënujtit e tërheq fantazinë e njeriut e aq më shumë atë të detarit. Kjo dukej qartë në sytë e polumbarëve. Po një punë e tillë nuk ishte aq e thjeshtë, çaste të tilla kërkojnë durim dhe gjakftohtësi. Petriti kishte organizuar dhe herë të tjera zhytje të tilla me detarët. Në të gjitha kishte dalluar padurim, e kishte njohur atë në shikimin e detarëve.

— Shokë, — foli ai me zë të ulët, — lundrimi ynë sot ka për qëllim kryerjen me sukses të kësaj detyre luftarake. Do të imitojmë avari në anije, çarje. Skuadra e punimeve nën ujë do të bëjë saldimin e hekurit jashtë anijes. Të dhënat i dini?

— Si urdhëron, shoku komandant, — u përgjigjën disa.

— Atëherë të mos e zgjasim se po afrohet darka. Të fillojmë zhytjen. Ju këshilloj të ruani njëri-tjetrin. Anija jonë të gjitha detyrat i ka kryer me sukses. Duhet t'i dalim mbanë dhe kësaj.

— Do t'ia dalim dhe kësaj, shoku komandant, — thanë polumbarët dhe u ngritën.

— Filloni daljen nga anija! — dha urdhër komandanti.

Polumbarët rregulluan kostumet. Saliu e ndihmoi Qemalin të vinte maskën në fytyrë dhe të hapte rubinetin e bombolës së ajrit. Petriti s'ia ndante sytë Qemalit dhe s'i shpëtonin lëvizjet e pasigurta të duarve të tij që shprehnin frikë, pse jo, dhe emocionin e momentit.

Kur dolën, Qemali menjëherë pas Saliut, u shtri në aparat. Uji që i ra me presion në fytyrë e tronditi pakëz, po kur ndjeu dorën e fortë të shokut që po e tërhiqte drejt thellësisë, grumbulloi forcat dhe e ndoqi me shpejtësi. Në ujë, para syve, u var litari i bardhë si valë televizive. Kur hodhi sytë sipër, shikoi trupin e errët të nëndetëses që dukej si një mal i lundrueshëm. Aty se si u ndal. Erdhi në vete kur Saliu i afroi dritën e një feneri që mbante në dorë. E tërhoqi mengadalë dhe qëndruan aty ku duheshin bërë punimet. Polumbarët e tjerë notonin përreth. Qemali nuk i shikonte ata, por i ndiente lëvizjet e tyre si dhe llokoçitjen e ujit përreth. Atë çast iu var në kokë mendimi se një difekt në maskë ishte i paevitueshëm. Ç'do të bënte? Ai nga vetë natyra e tij e humbiste shpejt. Kësaj ia kishte frikën. Ç'do të bënte po t'i ndodhte diçka...? Saliu përsëri ia ndriçoi fytyrën. Në thellësi drita e fenerit hyri drejt e në qenien e tij, dhe e përmbloodhi veten. Ia bëri me dorë Saliut të fillonin nga puna.

Puna filloi. Tani një valë e ngrohtë ia përshkoi trupin. Nuk po e ndiente më vështirësinë e thithjes së ajrit. Bënte lëvizje të lira dhe bile u përpoq të tregohej më aktiv në punën e ndihmëssaldatorit. Dy-tri herë e kapi shikimin e Saliut dhe i buzëqeshi. Iu kujtua dhe komandanti i anijes. Mirë kishte bërë që e kishte urdhëruar të zhytej. Në fillim i kishte bërë përshtypje këmbëngulja e komandantit, ndërsa tani e kuptonte sa drejt kishte vepëruar ai. Qenka shumë interesante të punosh nën ujë. Me



fantazinë e tij nuk kishte mundur ta përfytyronte dot këtë gjë. Saldimi i një pllake po merrte fund. Duhej vendosur akoma dhe një tjetër. Saliu i rrahu shpatullat në shenjë urimi dhe gëzimi njëkohësisht.

Pllakën e dytë ua afruan disa polumbarë të tjerë. Saldatori shtriu dorën dhe i bëri me shenjë Qemalit. Leva e mbajti atë horizontalisht, pastaj e ngritën lart mbi koka dhe e vendosën mbi bordin e anijes. Feneri tani e pengonte Saliun, ndaj ia zgjati Qemalit. Për një çast drita u fik. U bë errësirë e plotë. Kur u ndez përsëri feneri, Qemali nuk e pa shokun. Dhe pllaka e vendosur në bord nuk gjendej në vendin e saj. Ç'kishte ndodhur? Poshtë këmbëve lëvizti trupi i Saliut. U përpoq ta ndriçonte. Ai po ngjitej me ca lëvizje të çuditshme. Po ngjitej lart. Ç'donte lart Saliu? E shtrëngoi litarin dhe e kapi nga rripi i mesit. E mbajti fort dhe i ndriçoi fytyrën. Saliu dy duart i kishte vënë mbi maskë. Çfarë i kishte ndodhur vallë? Iu afrua dhe më. Saliut i ishte këputur tubi i ajrit të maskës dhe mbante me dorë vrimën e hapur. Përmes xhamave motoristi i ri dalloi përpëlitjet e një njeriu që po mbytej pa ajër. Tani e kuptoi se çfarë i kishte ndodhur. Pllaka, që me sa dukej kishte rrëshqitur në fund të detit, kishte prishur tubin e ajrit. Saliu ndodhej në rrezik. Ç'duhej bërë? Po. Iu kujtua ndihma e parë që jepej në raste të tilla. Hoqi me të shpejtë tubin në maskën e tij dhe ia lidhi maskës së shokut. Për vete e mbajti frymën aq fort, sa ndjeu dhimbje në tëmtha. Saliu menjëherë thithi ajër me tërë fuqitë dhe u qetësua pak. Mendoi se iu rregullua aparati i tij dhe filloi të thithte me etje ajër nga bombola. Qemali shtrëngoi nofullat fort. Sekondat po kalonin. Kur erdhi në vete, Saliu i bëri me shenjë Qemalit të vazhdonin punën. Ai i mori në dorë fenerin dhe ndriçoi trupin e anijes. Qemali tani ndiente

dhëmbje të forta në tëmtha. Sa sekonda kishin kaluar vallë? Kur lahej në lumin e shkollës me shokët, qëndronte më shumë se të gjithë i zhytur në ujë. Po tani sa e kishte mbajtur frymën? Nuk e llogariste dot kohën. «Tani i duhet hequr tubi Saliut. Ai ka për ta kuptuar difektin e maskës së tij. Po sikur ai të mos e ketë marrë veten akoma? Po... lëvizjet nuk i bën të rregullta. E ka tronditur shumë difekti. Përsë nuk më ndriçon me fener që të më shohë? Duhet pritur dhe pak... dhe pak...»

Instinktivisht dora i bëri një lëvizje të shkathët. As ai vetë nuk e kuptoi se si u krye ky veprim. Jeta ka ligjet e saj. Ia hoqi tubin maskës së Saliut dhe e vuri në maskën e tij. Thithi me të shpejtë ajër dhe përsëri ia kaloi tubin Saliut. Saldatori në fillim mbeti i habitur. I ndriçoi me fener. Kur dalloi tubin e prerë bëri një lëvizje pa kuptim, por që shprehte nervozizëm. Pastaj iu afrua. Në atë thellësi qenia e Qemalit u bashkua me atë të Saliut. Nën trupin gjigant të anijes ata ndanin ushqimin e mushkërive me njëri-tjetrin. Saldatori tani nuk e kërkonte me ngut ajrin. Mbasi bindej se Qemali merrte frymë fort, bashkonte tubin me maskën e tij. Asgjë nuk mund të mbante më shumë jetë dhe dashuri se ai tub ajri i vendosur në mes të dy njerëzve dhe shokëve. Vetëm deti mund të të falë të tillë gëzim dhe dashuri.

Ata të dy u larguan nga vendi i punës të ndihmuar nga shokët e tjerë.

Ata merrnin frymë së bashku dhe së bashku largoheshin nga ujërat e thellësisë.

\*

\* \* \*

Në nëndetëse skuadra hoqi kostumet e polumbarëve. Nga veshjet u kullonte akoma uji i thellësisë. Komandanti



dhe komisari i ndihmonin të hiqnin maskat e fytyrës. Për avarinë nuk bëri fjalë njeri. Ata s'ia ndanin sytë motoristit të ri.

Kur u shtruan të hanin darkë, komandanti i falëndëroi për kryerjen me sukses të detyrës dhe e lavdëroi guximin e detarit të ri. Qemali u detyrua të fliste se e shtynin shokët. Nga emocioni iu drodh pak zëri.

— Unë e dija se sa e shtrenjtë është jeta e shokut dhe ndihma e tij. Por atje në ujëra e provova edhe më mirë. Thellësinë nuk e dija se çfarë ishte. Ajo thellësi ngjau me thellësinë e shpirtit të shokut tim . . . të shpirtit tuaj, shokë. Të më falë komandanti për fjalët që i kam thënë para zhytjes. Të më falin dhe shokët. Njeriu i pamësuar u dashka marrë patjetër për dore. Unë e dua me gjithë shpirt detin, shokë. Jeta më e bukur imja është jeta e detit, kjo që bëjmë në anije.

Dhe u ul. Në çast Saliu i vuri përpara një pjatë sultjaç, «si shpërblim për ajrin që i dha në thellësi» sikurse u shpreh ai.

I tërë ekuipazhi qeshi. Qeshi dhe komandant Petriti.

Nëndetësja kishte kthyer kursin për në bazë. Nata e parë nën ujë kaloi e mbushur me dashuri dhe optimizëm.

## NË TUNEL

Tuneli po thellohej çdo ditë. Në thellësi të tij vazhdonin plasjet. Aspiratorët e bardhë pastronin pa pushim ajrin e tunelit. Minatorët po përgatiteshin për një shpërthim të ri.

Minatori i kësaj brigade, Ibrahim Këçuku, si të hynte për të parën herë në tunel, i kishte bërë sytë katër. Shikonte avancimin e punimeve dhe çuditej. Gjatë tri ditëve që kishte qenë në shtëpi, puna kishte ecur shumë, aq sa ai s'po u besonte syve. Iu kujtuan fjalët e brigadierit, kur i kërkoi t'i jepte ditët e pushimit. «Jemi në javën e sulmit, o Ibrahim, dhe ti kërkon të na lësh?» Po Ibrahim i kishte vendosur. E kishte marrë malli për të birin dyvjeçar. «Të gjitha javët javë sulmi i quan ky, i dha karar me mëndjen e tij dhe që nisur pa marrë aprovimin e brigadierit. Në shtëpi që kënaqur dhe e kishte harruar fare bisedën me brigadierin po tani që po hynte në tunel filloi të shqetësohej.

Vetngarkuesit hiqnin materialin e bërë nga minat. Minatorët po përgatisnin kallëpin e betonit dhe kaskat në kokat e lagura lëviznin ngadalë, si ca yje të çuditshme. Ata e përshëndetën shumë ftohtë Ibrahimin. Ose të paktën kështu iu duk atij. Kjo e vrau në shpirt. Profesionist i tij ia lehtësonte punën brigadës. Ai ishte specialist



për vendosjen e kallëpeve të betonit. Dhe tani ata nuk ia falnin gabimin. E ndjeu veten shumë ngushtë.

As dashuria e fëmijës në këtë çast, nuk po ia mbush-te dot boshllëkun që ndiente së brendshmi.

Përgjegjësi i turnit të parë iu afrua dhe i shtrëngoi dorën.

— Si je?

— Më lodhi paksa rruga, — u përgjigj Ibrahim.

Në të vërtetë deshi t'i thoshte se e ndiente veten të dërmuar, se e ndiente që kishte gabuar, por shoku s'qëndroi se ishte i zënë me punë. Ibrahim tani e ndiente se duhej t'i fliste një njeriu për brengën dhe dhimbjen e tij, ndaj i foli Saliut që kishte pranë.

— Kemi pasur shumë punë këto ditë. Jemi keq me planin! — foli shoku i tij si i hodhi një vështrim të shpejtë minatorit.

— Paska ccur goxha, — tha Ibrahim për tunelin.

— Jo mirë. Duhej më shumë.

Saliu kishte një trup më të shkurtër se Ibrahim, vinte më i imtë dhe i ishte rritur ca mjekra. «Kur rritet mjekra në tunel, është bërë punë», — thonë minatorët. Ismeti, kështu quhej përgjegjësi, kaloi dhe një herë para tij. Ai e njihte mirë minatorin. Ishin kushërinj. Rritur së bashku dhe pothuajse në të njëjtën kohë filluan punën hidrocentraleve.

— Ismet, — iu qep nga pas Ibrahim, — e bëra këtë gabim. Vajta të shihja djalin. Le që kam dhe ca halle të tjera në shtëpi. Kur ika nuk e mendova gjatë... Nga shtëpia i kishe mirë. Të bëjnë të fala. Samiu si është?

Ismeti i tha se Samiu kishte dalë në punë, edhe pse mjeku i kishte dhënë pushim tjetër për të marrë veten. Ky fakt ia rëndoi më shumë zemrën minatorit. Por e ndjeu dhe më të rëndë, madje mendoi se do të kishte pre-

feruar më mirë ta qëllonin me grusht fytyrës sesa të kishin vepruar ashtu kur Ismeti i tha se dhe vendin e punës ia kishin zënë.

Ibrahimi në fillim s'u besoi veshëve, po kur pa sytë e Ismetit që shprehnin keqardhje, ndjeu të rrëqethur në trup, thujse ujëra të rrëmbyeshëm iu futën nën lëkurë dhe e ftohën të tërin. «Vendin tim të punës e paskan zënë. Ç'të bëj tani?» E kishin zëvendësuar! E kishin ndarë nga puna, më mirë t'i thoshin se e kishin ndarë nga bota. Përgjegjësi i shtriu përsëri dorën. Ia shtrëngoi me forcë pëllëmbën dhe u largua. Tjetri u shkund. Ishte një e dridhur e fortë. Tani mendimet e sulmuan furishëm. «Shokët më kanë larguar nga brigada», — i foli vetes. Kishte mbetur si i gozhduar në vend e shikonte rrëkezat e pas-tra të ujit që lajmëronin pranverën.

U kthye nga dalja e tunelit. Vala e dritës së diellit i vrau sytë. Në të vërtetë e ndjeu të nevojshme të ulej diku dhe të qetësonte veten. «Ndaj s'ma zgjatën shokët kur më panë. Me siguri dhe atyre u ka ardhur keq kur kanë vendosur, sepse kemi kohë që punojmë së bashku. Po gabimi duhet dënuar. Ja dhe ata më dënuan...»

«E pranoj. Kam thyer disiplinën në punë. Disiplinën proletare, ndaj duhem dënuar. I dyti hidrocentral ky, që po ndërtojmë së bashku. Në tunel kam rritur shpatullat. Jam treguar liberal në disiplinë. Këtë po... Po përse kaq rëndë? Ata më njohin mirë dhe s'ma merrte mendja të kishin një mendim të tillë për mua».

Kjo rrëke fjalësh ia trulloi kokën. Pa pasur mendjen kishte qëlluar me grusht gjurin. Dhimbja që ndjeu e përmendi: «T'ua them shokëve gjithë këto fjalë? Po a kam të drejtë?»

I ktheu kurrizin diellit dhe në fillim e pati të vështirë të mësohej me errësirën e tunelit. Iu afrua bandave



të shpimit dhe u përzie me kaskat e minatorëve. Fytyrat e pluhurosura i hodhën ca shikime që, për çudi, kësaj here iu dukën të ngrohta. Ishin shokët e vjetër dhe të rinjtë me të cilët u njoh në këtë hidrocentral. «Ata përsëri më kanë shok». Por dukej sheshit se nga vendimi i tyre nuk do të luanin këmbë. Pa folur, ata ia shprehën mendimet e tyre me radhë. Kjo brigadë, ai e dinte, ishte një digë e tërë. Secili nga ata ishte një themel i fuqishëm.

Një sondist i ri, flokëkuq, e prishi heshtjen:

— Unë them ta tërheqim vendimin që morëm për shokun Ibrahim. Ai është punëtor i mirë. Dhe njeri i mirë është. Unë e shoh që ai e pranon gabimin.

— Po disiplinën në punë, — u hodh Faslliu, një minator i moshuar që dukej se ishte më i vjetri në brigadë. — Disiplinën në punë? Kush na lejon ta braktisim punën? Merret një Parti e tërë me të tilla probleme. E ti thua ta falim? Një fjalë e urtë thotë, se të vaditësh nuk do të thotë vetëm të derdhësh ujë, por dhe të mos e lejosh atë të dëmtojë bimët. Ibrahim, në tunelin e Vaut të Dejës, më ka shpëtuar jetën. Unë nuk ia harroj këtë. Po kur gabon, ai e kushdo qoftë, duhet të mbajmë qëndrim. Mua po më lënë fuqitë. Ky dhe ti keni për ta kapur martelin. Po ama ky braktisi punën. Tani nuk kemi kohë të humbasim, shokë. Hajdeni në punë. Me Ibrahimin ne jemi në një dhomë. Do të flasim përsëri. Unë e di, — Faslliu u kthye nga Ibrahim dhe mbështeti dorën e tij të madhe mbi supin e gjerë të Ibrahimit, — që ti e do tunelin dhe punën. Por gabove. Do të flasim përsëri.

Kaq tha Faslliu dhe u largua i pari. Pas tij dhe të tjerët shkuan në vendet e punës. Aty mbeti vetëm Ismeti.

— Për pesë muaj do të largohesh nga brigada jonë. Më vjen keq, por ti je punëtor dhe do të fitosh dashurinë e kujtdo. Do të bisedojmë më gjatë pas pune. Tani

shkojmë në drejtori të bisedojmë për vendin e punës. E vështirë është për ty të rrish pa tunelin, por ti vetë e braktise atë.

Ibrahimi qëndronte i menduar. Një valë e nxehtë, e çliruar nga brenga e ndërgjegjjes, filloi ta pushtonte. Lotët nisën t'i binin ngadalë në faqe. Qante i heshtur në fshehtësinë e tunelit. Qante dhe lotët e lehtësonin disi. Që tani ndiente mall për pluhurin e tunelit. «Brigada bëri mirë që nuk ma fali. Ata ishin më të mirë dhe më të drejtë se unë. Ata vepruan si duhej». Kështu mendonte ai dhe i dukej se tani mendimet e tij kishin lidhje mes tyre, mes atij dhe tunelit, që priste një plasje të re.

U nis me kokën e rënduar dhe me dëshirën për të hequr një peshë të rëndë nga shpatullat. Të tjerët që punonin për pastrimin e skarpateve dhe që dinin çdo gjë e përshëndetën. Dhe Ibrahimi s'e uli kokën, ai i shikonte në sy shokët. «Do të punoj, shokë, dhe me punë do ta fitoj besimin e humbur». Dielli iu duk se i shkriu atë ftohtësi që kishte ndier në trup mëngjesin e kësaj dite.



## NJË COPËZ NGA JETA IME

Dy ditë radhazi qëndrova brenda në tunel. Gjatë këtyre dy ditëve bëme shumë plasje dhe vendosëm një kallëp betoni të plotë. Kur filloi betonimi, mua më kishte zënë gjumi në skajin «e ngrohtë», siç e quanim në kabinën e makinës vetëngarkuese. Më zuri një gjumë i rëndë, sa që, kur më zgjuan shokët, se po më thërriste kryeinxhinieri, nuk mblidhja dot veten. Si u përmenda, vura re se kryeinxhinieri i kantierit që afruar. Dola nga kabina e vetëshkarkueses dhe u takova me të. Ai më bëri një sërë pyetjesh për punën e këtyre dy ditëve të fundit, se këto ditë puna s'na kishte ecur mirë. Unë, që me siguri dhe sytë i kisha të skuqur, i tregova deri ku kishte mbërritur faza e betonimit. Kryeinxhinieri më dëgjonte dhe herë pas here tundte kokën e tij të verdhë. Sektori ynë i shpimeve kishte takuar në zonë shkëmbore të shkrifët dhe rreziku shëmbjes qëndronte vazhdimisht pranë. Tërë puna kryhej me kujdes, si duke shkelur mbi një pllakë xhami. Kjo e shqetësonte dhe këtë djalosh energjik që qëndronte përballë meje. Si dëgjoi raportin tim, kryeinxhinieri rrudhi vetullat. Ai kërkonte mendimin se si duhej dalë nga kjo gjendje. Po unë, të them të drejtën, nuk e kisha as vetë të qartë se si duhej të vazhdonte puna në këtë sektor. Dukej sheshit se ai nuk mbeti fare i kënaqur. Fshiu djersët dhe më foli me ton të sigurtë:

— Këtu ka mungesë organizimi në punë.

— Shoku inxhinier, ju keni të drejtë. Në vendosjen e çimentinave nuk po na ecën puna. Unë dua ndihmën tënde për këtë proces.

— Çfarë ndihme? Ti punon me minatorët më të mirë. Përse e keni filluar punën ashtu si nuk duhet? Pas çdo plasjeje duhet të filloni pastrimin. Futni mjetet dhe mos u merrni me gjëra të kota. Menjëherë hapni vendet e dimensionit seksional dhe ngrini sentinat për t'u dhënë front pune minatorëve. Ti ke qëndruar pa gjumë dy ditë. Shqetësimi yt është i drejtë, por duhet organizim më parë. Dhashë urdhër të merren seksionet. Më vonë do të shihemi përsëri. Më të qetë në punë. E mira është të pushoni dhe shihemi në darkë. Shko e fli, vëlla!

Ai u kthye dhe trupi i tij i madh e ndau dritën që hynte në galeri në dy pjesë, ashtu si u ndanë dhe mendimet e mia. Ai djalosh me ecjen e tij të qetë më dukej sikur po hidhte hapat mbi pasionin tim. Nuk ishte përleshur me shkëmbin ai sa unë. Por, në fund të fundit, kishte të drejtë. Punët nuk më shkonin mirë ashtu si më kishin shkuar gjithnjë. Mendjen nuk e kisha më të freskët. Mendova se bota kishte ecur më përpara se unë që vazhdimisht mbaja në kokë një kaskë të vjetër. Bota kishte ecur dhe më dukej se e shikoja atë përsëri në një kënd dritëvogël.

Tani tek unë mungon organizimi i vogël i punës. Ka shumë të drejtë të mendojë ky inxhinier se unë jam i paditur në punë. Por ai nuk e mendon një gjë të tillë. Unë e di këtë. Dhe më vjen mirë. Ky ka bërë shkollë, sigurisht. Goxha djalë i ditur, të heq vërejtjen me të drejtë. Është inxhinier prodhimi dhe ia di mirë të gjitha të fshehtat punës.

U çlirova disi nga këto mendime që vërtiteshin rreth



meje, si një shtëllungë e murme pluhuri, kur dëgjova zërat e shokëve.

U afrova të shokët e mi minatorë. Në fytyrat e të gjithëve lexova menjëherë urdhrat që kishte lënë inxhinieri. Ata, me sa shikoja unë, ishin gjallëruar. Mua më kishin lënë të flija. Përse më kishin lënë? Mos vallë nuk kishin më besim tek unë? Dikush prej tyre dhe më bënte dredha me sy e nuk donte ta kapte shikimin tim hetues. Mos vallë ata e ndienin përgjegjësinë e kësaj pune më shumë sesa unë? Po, kështu shihej. Ata ma njohin mirë shpirtin. Përse të më linin të flija? Përse? Dhe ky qëndrim i akullt ç'të jetë?

«Përse më latë të flija, shokë?» — se nuk u thashë.

Zura t'i vështroja me radhë. Me ç'të drejtë duhej t'u fisja ashtu?! Unë isha, në fund të fundit, një punëtor i asaj brigade dhe puna duhej shtruar sipas urdhrave të dhëna. Pse duhej të zgjatesha? Si brigadier, unë nuk kisha ditur të drejtoja në këtë proces. Ja, tani inxhinieri na ndihmoi vërtet. Dhe shokët me të drejtë janë gjallëruar. Ja dhe shokët e mi të vjetër. Edhe ata heshtin. Dhe atyre u vjen rëndë të flasin e të më thonë se unë nuk kisha ditur të drejtoja këtu.

— Nuk duhej të më kishit lënë të flija. Këtu duhen krahë pune për të qeruar anët e tunelit, sipas udhëzimeve të inxhinierit. Edhe më parë duhej bërë kjo punë. Por mendja ime... s'isha gjendur ndonjëherë në një situatë të tillë, more vëllezër. Këtu nuk është vendi të derdhim djersën kot. Më duket se jam tunelist shumë i vjetër, po nuk i ditkam të gjitha proceset e tij. E shoh se duhet shembur shkëmbi sipër galerisë. Keni kundërshtim, vëllezër? — Dhe hodha shikimin nga Hasani, moshatar me mua dhe minator gjithnjë i dalluar dhe shumë i aftë. Ai madje, është dhe i gojës dhe flet ashpër e pa frikë.

Hasani, si të më kishte kuptuar vështrimin, më pa miqësisht dhe sqaroi deri diku heshtjen e brigadës:

— More Ivzi! Ti je punëtor i madh dhe ç'është e vërteta ne nuk kemi mbetur në vend. Puna me ty na ka ecur mirë, po këtu është shkëmb i rrënuar dhe shpimi nuk ka ritmin e tuneleve të tjera. Të lamë të flije. Ke dy ditë pa gjumë. Nuk është mirë kështu. Ti e kupton këtë, jo vetëm për shëndetin por kur është e lodhur kjo e shkreta, — dhe goditi me dorën e mbledhur grusht kokën e tij thinjoshe, — s'është as për punë.

Hasani heshti ca dhe më vështroi. Unë rrija si i ngrirë. Ai heshti dhe pak dhe duke u menduar shtoi:

— Askush nga ne nuk mendoj të të nxirrte ty jashtë luftimit. Ti ishe lodhur dhe ne të lamë të flije. Kështu. Mos u zemëro më kot. Ne jemi miq të vjetër. Lëri këto dyshime. Tani do të pastrojmë ballin e tunelit. Ti brigadieri ynë je përsëri.

Hasani fliste dhe dyshimi im filloi të shuhej. Unë doja të shuhej ky dyshim, se e dija fare mirë se ç'do të thotë të mendojnë një gjë të tillë shokët. Tani e dija. Brigada priste nga unë përsëri. Gjumi më kishte bërë mirë.

Iu përveshëm punës. Dy nga shokët po hiqnin tubat e ajrit të shtruar përtokë dhe pastronin diçka. Unë kontrollova vendosjen e dinamitit dhe i kënaqur nga puna e shokëve të rinj u bëra shenjë me dorë të tjerëve të dilnin nga tuneli. Prej andej galeria përballë mernte formën e një grope vullkanike. Ai tunel, sa një boj njeriu, tregonte udhën e tuneleve të ardhshme.

Kur u larguan të gjithë nga vendi i punës, dy shokëve të mi minatorë u dhashë urdhër të shtrinin deri në dalje fitilin. Plasja do të bëhej shpejt, se nuk kishim shumë kohë për të humbur. Ata e zbatuan urdhrin tim



dhe në çastin kur po kontrollonim vijimin e fitilit, para syve tanë u shkëput nga sipër një shkëmb i madh. U ngrit aq pluhur sa për një çast ne nuk pamë njëri-tjetrin. Unë thirra dy shokët e mi. Ata m'u përgjigjën, por në atë sekondë u dëgjua plasja e llahtarshme e dinamitit. Shkëmbi kishte rënë mbi dinamit dhe ai shpërtheu. Tunneli u drodh si një peshk gjigant kur ndeshet papritur me dallgët e detit. Copëra gurësh na ranë mu pranë. Copëra gurësh të tjerë u hodhën në thellësi të galerisë, ku ishin të dy minatorët e rinj. Pluhuri që m'u përplas në fytyrë dhe zuri shtresë, vendosi dhe qetësinë e këtyre çasteve. Një qetësi endej mbi të gjithë galerinë. Zura të thërrisja fort, që të mund të më dëgjonin shokët.

— Zaim! Zaim! Hysni! O Hysni! Përgjigjuni shokë! Zaim! Zaim! përgjigju! Nuk ju shoh! Jam shëndoshë, ku jeni? Hysni, ore burrë! Zaim! Z. a. i. m! Z . . a . . i . . m!

Pastaj të gjithë hipën mbi gurët e shembur. Hyrja e galerisë ishte shembur plotësisht. Zaimi dhe Hysniu ishin përtej gurëve dhe nuk përgjigjeshin. Dy mundësi kishte, ose ishin nën gurët e shembur, ose brenda në galeri të mbyllur. Një gjë ishte e qartë. Jeta e tyre ishte e dyshimtë. Inxhinieri pa kaskë, erdhi si furtunë. Më shikoi me vëmendje dhe pyeti me sy ç'kishte ndodhur. Kur i tregova për Zaimin dhe Hysniun, ai shtypi buzët me dhimbje. Shikoi gurët, pastaj galerinë e shembur. Balli i ishte qullur në djersë.

— Kishin kohë të hynin në galeri? — më pyeti mua.

— Pak sekonda më duket. Shumë pak. Por ata ishin të shkathët.

— Forca të hapim galerinë! — urdhëroi ai dhe unë, që ia dija të fshehtat shkëmbit, kërkova dërrasa për t'i bërë mbrojtje.

Të gjithë sulmuam gurët e galerisë. Gërmonim me

duar, me kujdes, sikur po ndanim grurin nga thekra. Kur u hap një vrimë, u thirrëm shokëve. U thirrëm të gjithë së bashku si në një kor. Ata u përgjigjën. Zëri i tyre na u duk si ai dielli i fuqishëm përmes reve, që shpërdan era e pranverës.

— Ore Zaim, është plagosur ndonjëri nga ju?

Zaimi nuk u përgjigj. Unë nisa të futja të parën dërrasë në galeri për t'i mbrojtur. Ndërsa brigada po hiqte gurët e tjerë, unë vendosa dërrasën e dytë dhe të tretën. Pastaj hyri dhe drita në botën e errët të shokëve të izoluar. Unë pashë fytyrat e tyre. Hysniu ishte gjakosur në ballë. Zaimi buzëqeshte si një fëmijë. Për t'i mbajtur dërrasat në anën time erdhi dhe inxhinieri. Zaimi u ngrit brenda në galeri dhe vuri shpatullat e tij. Hysniu dergjej përtokë. Shokët vazhdonin pastrimin. Punët po na shkonin mirë, kur u ndie të binte pluhuri i zakonshëm që paralajmëronte shembje të re. Minatorët u shtangën. Mbi kokat tona po përgatitej rrebeshi i gurëve, nga damarët e plakur të shkëmbinjve. Duhej të iknim nga ai vend. Por ndodhi ajo që nuk pritej. Minatorët nuk u larguan po vrapuan e sollën bina, dhe na lehtësuan nga peshë e dërrasave. Unë u dhashë urdhër të largoheshin.

Pas meje u foli dhe inxhinieri, por Hasani, që ishte më pranë daljes, s'bëri hap para dhe, kur currilat e pluhurit erdhën dhe u shtuan shokët u afruan të gjithë pranë njëri-tjetrit. Asnjëri nuk bëri të dilte por u ngjeshën aq shumë bri njëri-tjetrit, sa nuk kuptohej se ku mbaronin krahët e njërit dhe ku fillonin të tjetrit. Çdo shkëmb që mund të binte, qoftë edhe nga zemra e tokës, do të mbetej pezull mbi skelë, larg trupit të shokut të plagosur. Brigada ishte bërë një, por sa do të vlente kjo për të mbajtur peshën e një shkëmbi ose të disa shkëmbinjve? Pluhuri u kthye në copëra gurësh të vegjël. Vësh-



trimi i të plagosurit na tregonte mirënjohje dhe lutje me dëshpërim bashkë. Ai na lutej. Na lutej të iknim nga rreziku i ri. Po ku të shkojmë ne, more shok i dashur. Ti je yni. A nuk punuam bashkë në Vaun e Dejës dhe në Bistricë miku ynë, shoku ynë i ri? Ti a nuk u përleshe me shkëmbin ashtu si të mësuam ne? Jo, more vëlla! Ne jemi të fuqishëm se jemi shumë dhe do ta mbajmë mbi shpatullat tona shkëmbin. Përpiqu të mbahesh dhe pak sa të kalojmë këtë rrebesh. Kështu Hysni, vëlla! Forca! Forca!

Këtë dialog të brendshëm me të plagosurin e bënte secili prej nesh. Kjo shihej përmes dritës së syve. Ndërkaq ranë gurët e parë, të cilët nuk peshuan pothuaj fare mbi dërrasa. Megjithëse gurët ishin lajmëtarë të një shembjeje të madhe, përsëri shokët nuk lëvizën. U ngjeshën më shumë dhe ashtu me supe të përkulura u ngjanin statujave antike që mbanin kollona të tëra. Vetëm pak metra larg nesh jeta fliste me gjuhën e saj të gjallë, të zakonshme. Tani, nën peshën e gurëve, jetën po e vlerësonim me dimensione që dilnin jashtë vetes sonë. Ruanim jetën e shokut të izoluar. Filloi shembja e re. Masa e malit rrokullisej mbi kokën e të gjithëve. Po ne ishim të bashkuar dhe masa e madhe e besimit mbante malin.

Gurishtet, që ishin si djersët e shkëmbinjve, binin si të lodhura mbi kokat tona. Unë thirra:

— Mbahuni shokë! Tani fillon shembja më e madhe. Deri tani këto qenë paralajmërime. Duart puthitnin mirë pas shkëmbinjve! Shkëmbinjtë pengojnë njëri-tjetrin dhe krijohet një urë peshe.

Ata e zbatuan të gjithë këshillën time. Si ngritëm shpatullat tona, shembja u bë. Ishte shembje në cepat e hollë. Dërrasa që mbante inxhinieri dhe Hasani u thye. Ata u mbuluan nga pluhuri. Unë nuk kisha si t'i ndih-

moja se mbaja dërrasën nga ana ime. Por të tjerët vunë shpatullat e tyre. Pas pak gjendja u qetësua. Unë dhe Zaimi ndihmuam Hysniun e plagosur. E ngriti dhe inxhinieri.

Jashtë, hyrja e galerisë u çel pothuaj e gjithë. Nga që shembja ishte e madhe, te vendi i punës ishin grumbulluar shumë punëtorë që ndihmonin. Të gjithë flisnin, largonin copërat e shkëmbinjve. Hasani buzëqeshte dhe u foli diçka shokëve. Dikush dhe u largua. Sigurisht shkonte të merrte diçka për të ngrënë. Ndoshta dhe për të thirrur shokët. Kjo mund të ishte më e sigurtë. Inxhinieri më futi krahun dhe më shikoi me dashuri. Në sytë e tij unë shikoja shumë gjëra të reja, lexoja fjalë të pathëna që i kishin mbetur në buzë.

— U tregove mjeshtër i madh tunelesh, brigadier, — vetëm kaq më tha. Hasani ishte afruar pranë nesh.

— Hajde vemi pimë nga një kafe, — tha ai.

— Vemi, — tha dhe inxhinieri.

Unë shikova shokët e mi që qeshnin dhe gëzonin. Për ta tani çdo gjë kishte shkuar. Ne asnjëherë nuk rrinim të përtypnim gjatë shembjet dhe rrënimet. Ajo kishte kaluar.



## GURËT E ÇMUAR

Çdo buzëmbremje ai kthehej nga majat më të larta të maleve, ku rrallë kishte shkelur këmbë njeriu.

Kishte shumë vjet që e bënte këtë rrugë plot rreziqe.

Në fshat zbriste gjithnjë me një torbë të rëndë, mbushur me gurë të çmuar mineralesh. Shumë vite brodhi me atë torbë supeve. Kërkoi me radhë vargmalet e Dukagjinit dhe të Tropojës. Mblodhi në rrëpira dhe pllaja alpine gurë nga më të ndryshmit. Disa fshatrave u gjeti ujë të pijshëm dhe burimet e ndryshme ishin si piketa që fare thjesht mund të tregonin udhën e tij. U dha këshilla njerëzve për të ndërtuar mullinj, për të hapur toka buke, dhe me gurët e medicinës, që i nxori nga thellësia e shpellave, nisi të shëronte plagët e lëkurës. Ai fliste me zë të qetë dhe të shtruar, sikur donte të të shëronte me fjalët e tij dhe asnjëherë nuk mërзитеj e as nuk zemërohej. Për këto dhe shumë gjëra të tjera, Xhaferri, u bë njeri i dashur për të tjerët. Po i kishte ndezur shërrin me gruan.

Sado që Xhaferri përpiqej t'ia mbushte mendjen asaj se këto gurë të çmuar me ngjyra të çuditshme, do të vlenin një ditë, ajo nuk e pëlqente zanatin e të shoqit. Ai vërtet kishte dëgjuar për gjeologët dhe për mineralet

që nxirrnin kokën si lulëkuqe në sipërfaqet e maleve, po dinte shumë pak gjëra, prandaj nuk qe në gjendje t'ia mbushte mendjen gruas me fjalë dhe mundohej t'ia shuante inatin me një buzëqeshje të ëmbël. Kështu që ai vazhonte të njëjtën rrugë, çdo pasdite merrte malet me torbën e vjetër e të grisur hedhur krahëve.

Kështu rodhën ditët, gjersa një mëngjes, në fshatin e Xhaferrit, me një zhurmërimë mbytëse dhe pluhur u dukën ushtarët gjermanë. Ndërsa i shikonte nga larg, iu dukën si hordhi turke, lëviznin me të shpejtë.

Lugina e Drinit atë ditë gushti u mbush me hingëllimat e mbytura të kafshëve të ngarkuara. Gjermanët vinin nga Gjakova. Vapa digjte dhe nuk mund të qëndroje në diell. Njerëzit e gjetur në befasi zunë vend para shtëpive. Fshati ishte i bardhë dhe ai grumbull uniformash e kuajsh të hirtë dukej si njollë vigane që mundohej të përhapej nëpër fshat.

Në fshat të huajt u freskuan te përroi. Si pinë për vete u dhanë dhe kuajve. Lëvizje tjetër nuk bënë pothuajse fare. U ndanë grupe-grupe krejt të çrregullt, sipas qejfit, thuajse kolonën nuk e komandonte njeri. Pasdite u pa se kolona po bëhej gati për udhëtim dhe vonë, shumë vonë, kur dielli ishte rrokullisur pas maleve, u nisën.

Fshatarët u mblodhën dhe s' dinin si ta shpjegonin këtë që ndodhi. Po të nesërmen ndodhi ajo që i habiti të gjithë. Gjermanët kishin lënë në fshat katër ushtarë të armatosur. Sigurisht ushtarët e mbetur e kishin kaluar atë natë te shtëpia e priftit, sepse vete ai, rëndë-rëndë po i shoqëronte të huajt që pa gdhirë nëpër udhët e gurta të fshatit. Ata në fillim u ndalën te përroi, po kur e gjetën të prishur nga kafshët e kolonës që kishte shkuar, u vunë në udhë.



Xhaferri atë mëngjes ende nuk kishte dalë nga shtëpia dhe burrë e grua u stepën kur panë priftin me të tjerët t'i afroreshin shtëpisë së tyre. Të dy me gjak të ngri-rë vështronin nga dritarja sheshin, që binte përballë shtëpisë së tyre dhe tërë ngjarjen, delikatesën e shtrirë të të huajve, lëvizjet lajkatare të priftit, të cilat thuajse i bënte për të tërhequr fshatarët.

Ishte një ditë po aq e bukur sa ajo që solli kolonën e ngarkuar. Në një ditë të tillë, fshatari i këtyre anëve zinte që pa gdhirë ngastrën e të mbjellave. Por sot te të gjithë ishte futur merak i heshtur i kujdesit për fisin. Disa shtëpi të këtij fshati kishin djemtë në male, me partizanët dhe familjet e tyre dyshonin se mos i kontrollonin e i plaçkitnin. Prishja e përroit ishte një shenjë ogurzezë. Gjermanët, ashtu siç bënin dhe turqit, më parë mbollën etjen. Gjithashtu dhe rasoja e priftit ndillte në mendimet e njerëzve diçka të zezë e të kobshme. Prifti endej mes ushtarëve gjermanë dhe diçka u thoshte me zërin e tij të ulët dhe në gjuhën e tyre.

Xhaferri vazhdonte të rrinte pas dritares së ngushtë duke bluar të tilla mendime. Burrë e grua qëndronin të heshtur, pa folur fare. Ushtarët dhe prifti vazhdonin të flisnin dhe tashmë i qenë afruar shtëpisë së tyre. Gurëmbledhësi ndjeu djersitjen e lehtë të qafës. Ai ishte i tronditur.

— Duhet të mos i lë t'i afrohen shtëpisë. Ti mos u shqetëso! Ndoshta ata nuk e dinë se unë mjekoj të plagosur. Mos u shqetëso! Ma bëjnë me dorë. Është dhe prifti që u thotë diçka. Kurrë nuk më ka pëlqyer ai njeri. Çfarë u thotë vallë?

— Prifti është njeri i mirë. Kushedi se çfarë kanë!

— Prifti është ujk i vjetër, — ia preu shkurt Xhaferri dhe doli në derë.

Nga prapa përsëri gruaja po i fliste me zë të mbytur:

— Tregohu i matur! Pash kryet e djalit, tregohu i matur, dëgjon?!

Ai tundi kokën në heshtje dhe ia nguli sytë së shqes. Ajo ishte hequr shumë në fytyrë këto kohët e fundit. Sytë e saj u ngjanin dy tuneleve të thella.

Ktheu krahët dhe doli nga shtëpia. Xhaferrit iu duk vetja si përpara një rrëpire që duhej kaluar me mundime. Ç'kërkoni vallë nga ai? Iu kujtuan përsëri sytë e gruas dhe të fëmijës.

Njëri nga ushtarët ishte oficer. Nga larg nuk binte në sy. Xhaferrit vërejti se edhe në moshë ishte shumë më i madh se ushtarët e tij. Oficeri i hodhi ca vështrime plot interes Xhaferrit, në të cilat vihej re dhe një përbuzje e lehtë. Pastaj fshiu djersët. Prifti e përshëndeti me kokë Xhaferrin. Ai nuk u përgjigj. Pa fytyrat e menduara të ushtarëve dhe vuri re se ata ishin të ngrysur. Flokët e verdhë u binin mbi ballë. Prifti, që u shërbente si përkthyes, bëri një hap përpara më pranë fshatarit dhe i foli me zë të lartë:

— Xhaferr, ne do të bëjmë një vizitë në shtëpinë tënde. Prandaj erdhëm këtu.

Prifti u përpoq t'u jepte fjalëve tonin e predikatorit, po nuk i erdhi fare mirë kur dalloj në sytë e gurëmbledhësit një qetësi të akullt.

— Nuk më dëgjuat, o njeri i zgjuar?

— Ju dëgjova zotëri. Por ju e dini se unë jam fshatar i varfër. Me çfarë do t'i gostis këta ushtarë unë? Unë s'kam gjë tjetër veç hallit.

Prifti hiqej si njeri i matur, po në të vërtetë i dridhej mjekra kur këmbëngulte tjetri. E kuptoi fare mirë se ç'deshi të thoshte fshatari. Pa u nxituar përktheu



ca fjalë në gjuhën e të huajve, u buzëqeshi përsëri ushtarëve dhe priti që vështrimin e tij ta kuptonte fshatari. Xhaferri disi i lehtësuar po bluante në kokë arsyen përse këta të huaj donin t'i bënë një vizitë. Priftit as që ia vari fare. Pastaj papritur ra një heshtje e shkurtër.

U dëgjua një gaz i lehtë si pasojë e një grumbulli fjalësh të pakuptueshme që foli kleriku. Gurëmbledhësit nuk i qeshej. Atij po i hidhërohej goja si të kishte pirë helm.

— Qetësohu, or Xhafë. Kanë ardhur për një hall dhe këta.

Prifti foli përsëri duke qeshur, si të donte t'i mban-te ison oficerit. Xhaferri ndjeu dëshirën e madhe të largohet, sido që ishte i fyer, të ngjitej në malet e tij, të vraponte që tani. Po ku të shkonte? Nga cila anë? Po dhe sikur të ikte, ç'do të ndodhte vallë? Këta me siguri që do t'i vrisnin fëmijën dhe gruan. Do ta qëllonin dhe atë pas shpine. Njëlloj ishte, dhe po të qëndronte këtu; këta të huaj nuk duheshin futur në shtëpi. Si të uleshin këta këpurdha të kobshme në shtëpinë e tij me minder të pastër? Ai kishte jetuar tërë jetën me nder dhe kjo do të quhej tradhti ndaj të gjithëve. Hodhi sytë përreth, pa mälësorët që ishin mbledhur një e nga një dhe që qëndronin si të ngrirë sepse nuk po merrnin vesh se ç'po ndodhte. «Prifti më ka futur në një lak të keq. Është dhel-për ai». Kështu kishte qenë gjithnjë dhe asnjëherë nuk e kishte dashur gurëmbledhësin e varfër dhe të urtë.

«Shkurt, — tha ai me vete, — i duhet bërë bisht fjalës së priftit».

— Një derë e pasur dhe e nderuar, si selija juaj, nderon tërë fshatin për pritje miqsh. Unë po sjell një qengj.

— More njeri i zgjuar, po ne nuk do të rrimë në shtëpinë tënde. Këta të huaj janë gjeologë. E kupton se çfarë do të thotë gjeologë?

— Kam dëgjuar diçka në kohë të Italisë. Edhe italianët patën ardhur njëherë këtej po s'bënë gjë; duket s'gjetën gjë dhe u larguan, — iu përgjigj Xhaferri.

— Mos më dredhoni, o njeri i zgjuar, sepse nuk kemi dhe aq kohë për të humbur. Ti i ke bredhur malet me pëllëmbë. Këta janë miqtë tanë. Janë anëtarët të ekspeditës dhe duhet t'i ndihmojmë. Për të mirën tonë përpiqen këta. Se mos do ta ndërtojnë minierën në vendin e tyre! Ku gjendet mineral, atje ngrihet një minierë. Më tepër se të gjithë ne, ti duhet të kuptosh nga këto punë. Hë, si thua?

Xhaferri përsëri heshti dhe i tha vetes: «Qëndro burrë! Mos u gënje! Edhe italianin kështu tha».

Prifti përtypi me neveri qëndresën e fshatarit. Ushatarët ngurosën shikimet si qelq. Në atë sekondë nxori kokën padurimi. Kleriku i shkathët nuhati lëvizjen e oficerit dhe shpejtoi.

— Pse rri menduar, ore Xhafë?! Të zuri frika?! Kemi ardhur për të parë grumbullin e mostrave të mineraleve që ke mbledhur ti. Këta interesohen për mineralet e këtij vendi. Për këtë do të hapin një minierë këtu të punojnë të gjithë burrat, dhe fshati ynë do të bëhet një qendër e dëgjuar. Gjermanët janë një shtet i fuqishëm. Zoti na e solli të mirën te dera. Duhet të përfitojmë nga kjo. Këto male është e pamundur të mos kenë minerale. Ja, koleksionin tënd do ta blejnë këta dhe do të të japin miell për të gjithë vitin. Tani mos na mbaj më, por na i trego arkat e gurëve.

Xhaferri i kishte kaluar të dyzetat. Në mendje nuk i kishte vajtur ndonjëherë se në një ditë si kjo e sotmja



do t'i kalonte para syve tërë jeta e tij. Ku nuk kishte vajtur ai për të gjetur këta gurë minerali: në luginat më të pjerrëta, pranë brigjeve të lumit, duke gjurmuar udhën e gurëve, në mes të ftohtit dhe të shiut, përpjetë dhe tatëpjetë maleve! Shumë pak njerëzve ua kishte hapur zemrën, por sidoqoftë të gjithë e dinin se çfarë bënte Xhaferri dhe vetë atij i pëlqente që të tjerët t'ia vlerësonin në heshtje punën që bënte. Shkurt, e gjithë jeta e tij ishte lidhur ngushtë pas këtyre gurëve të çuditshëm me ngjyra të ndryshme.

Hodhi dhe një herë shikimin mbi fshatarët që rrinin të heshtur dhe që tani e kishin mësuar se çfarë donin pushtuesit nga ai. Shikimet e tyre e shigjetonin me një kuptim të vetëm si t'i thoshin: «Mos u dorëzo! Mos ua jep gurët fashistëve!» Ndërsa Xhaferri vazhdonte të mendonte në heshtje: «Jam njeri që kam vuajtur tërë jetën për të nxjerrë kafshatën e gojës! Asnjëri nuk i kam bërë keq. Përse m'u qepën këto halle, të shkretën!» Në këto çaste klithma e klerikut i shpoi përsëri veshët. Ai vazhdonte t'i kërkonte të dorëzonte gurët dhe nuk po i buzëqeshte më.

Xhaferri e pa priftin në sy. Ata ishin të trubullt dhe pas tyre fshihej diçka e kobshme.

— Përse mendohesh? Patriotë jemi të gjithë! Për të shpëtuar kombin bëhemi therorë të gjithë. Unë parashi-koj më larg. Dhe ti duhet ta kesh menduar diçka të tillë. Hajde, tani, nxirri arkat jashtë, ose ne do të futemi brenda!

— Ata gurë nuk kanë vlerë, zotëri, — munda të thoshte fshatari dhe buza iu drodh. — I kam bërë kalldrëme ata të mallëkuar gurë, sa më kanë tallur të gjithë. Mos më bini në derë për ata... — dhe heshti përpara zemërimit që dogji «njëriun e zotit».

Të huajt diçka kuptuan. Shikuan priftin, fytyra e të cilit shkëlqente nga djersa.

Fjalët e Xhaferrit krijuan papritur dy fronte. Në një-rën anë ushtarët, që nga çasti në çast ishin gati të hidhe-shin me armë për të mos humbur kohë dhe nga ana tje-tër rrinin fshatarët, të lehtësuar në shpirt nga heshtja e njeriut të tyre. Në ato pak sekonda gurët që kërkoheshin u futën në mendjen e çdo njeriu si një pasuri që u për-kiste të gjithëve. Shkurt, mineralet u futën në ndërgje-gjje si çdo pjesë e ndjesive dhe të tokës, pas së cilës këta fshatarë të varfër ishin lidhur ngushtësisht. Por njëri front duhej thyer. Në mes qëndronte figura e «njeriut të zotit». Ai foli përsëri, por tani fare shkurt, se mendoj se do ta bindte Xhaferrin.

— Dëgjo, more i shushatur! Përse i bën vetes dëm? Mblidhe mendjen! Nxirri ata drej gurësh dhe mos u laj-thit kështu. Nuk bëhet shaka me këta. Do t'i gjejnë dhe pa ty. Përse ta prishësh? Këta nuk largohen këtej pa ua dhënë ata drej gurë. Po nuk ua dhe, nuk ikin pa na e bërë të keqen!... Thuamë mua, përse nuk do?

Xhaferrin, tani shumë i shqetësuar, nuk iu përgjigj me zë, vetëm tundi kryet në shenjë mohimi dhe shumë i vendosur në të vetën. Oficeri e kuptoi se ç'po ngjiste dhe nuk priti më. Në çast e urdhëroi për diçka një ushtar me një zë çuditërisht të butë dhe të shtruar. Ushtari qëlloi me automatik dritaren përballë. Një britmë gruaje dhe fëmije u dëgjua që brenda shtëpisë dhe të lebetitur dolën jashtë. Pastaj ra një qetësi e kobshme. Xhaferrin **deshti të lëvizte e t'u afrohej gruas dhe djalit e t'i qetë-sonte, por oficeri përsëri urdhëroi diçka.** Këtë herë gu-rëmbledhësi, pa e ditur as ai vetë pse, e kuptoi se gjer-mani e urdhëroi të mos lëvizte. Hodhi sytë në atë drej-



tim nga kishin qëlluar me automatik dhe pa xhamin e thyer që dukej si një copë qiell i copëzuar. Përsëri deshi të shkonte drejt asaj cope qielli dhe përsëri gjermanët thanë diçka të vrazhdë në gjuhën e tyre. Tani urdhëronin ata dhe prifti, duke u shtirë gjoja si i menduar, në të vërtetë ndiente një gëzim të pafund dhe të paanë. Dy ushtarë vunë në mes gruan dhe djalin, ndërsa një ushtar tjetër hyri në shtëpinë e Xhaferrit. Pastaj shkoi dhe një i dytë sipas urdhrit të oficerit. Pas pak të dy ata dolën me arkat e mineraleve në duar dhe i derdhën pranë këmbëve të Xhaferrit, ku u tha eprori i tyre. Oficeri ndërkaq u ul në gjunjë dhe po shikonte me kujdes përbërjen e mineraleve. Filloi t'i flistë me entuziazëm priftit dhe duke bërë herë pas here «gut, gut» nga Xhaferrit.

Njëri nga ushtarët qëndronte vazhdimisht rojë. Kur i veçuan kampionet, oficeri, pa kërkuar ndihmën e përkthyesit, iu afrua Xhaferrit. Tani çdo fjalë e tij ishte një urdhër i prerë. Vërtet gjuhën nuk ua kuptonte Xhaferrit, por nga lëvizjet e nazistit ai e mori vesh se po i kërkonte t'i tregonte vendet ku i kishte gjetur gurët, prandaj me vështrimin nga malet e me një qëndrim të paepur as që ia hodhi sytë oficerit. Nazisti u egërsua më keq dhe urdhëroi priftin t'a përkthente ato që kiste thënë.

— Do t'u tregosh vendet ku i ke gjetur këta gurë minerali, Hajde tani, lëre trimërinë! Ti e sheh, gruan dhe djalin i ke në rrezik! Apo je i verbër?! — iu kërcënua edhe prifti fshatarit me një ton si ta paralajmëronte për gjëmën më të madhe që mund ta gjente në jetë.

— Po të jetë e thënë, le të ngjasë dhe ajo, — iu për-

gjigj Xhaferri dhe hodhi sytë mbi fshatarët, të cilët qenë afruar dhe me fytyra të egërsuara po prisnin ç'do të ngjiste.

Prifti u tregua i shkathët.

— Mos u trego kokëfortë, — thirri. — Duhet dëgjuar zëri i zotit!.. Shpejto! Luaj! Përse të mos u tregosh vendin?! Ç'dëm të bëhet ty!?

— Po, po... murmuriti Xhaferri, më së fundi, si i zënë ngushtë.

Përgjigjja e tij ishte shenjë pendimi. Të paktën kështu iu duk të gjithëve. Në çast kleriku drejtoi me gjallëri shpatullat. Fshatarët përreth lëvizën. Ishte një lëvizje e tillë sikur të kishte rënë tërmeti nën këmbët e tyre. Disa burra u larguan duke pëshpëritur diçka. Trupi i gurëmbledhësit u mblodh dhe u zvogëlua kur pa fshatarët të largoheshin. «S'ka gjë, ata do të më kuptojnë më shumë se kurrë, por duhet ta mbaj veten.» Tani ai ngjante me një statujë të lashtë luftëtari, të porsanxjerrë nga dheu. Pa e mbledhur veten mirë, u foli atyre që merreshin me gurët dhe ëndrrat e tij.

— Thuaju, padre, se do t'i shpie atje ku i kam gjetur këto minerale, por kam një kërkesë:

Kleriku ktheu kokën për ta dëgjuar me vëmendje, duke i bërë njëkohësisht edhe me shenjë që t'i thoshte kërkesat e tij.

— Lumin do të kalojmë me trapin tënd, zoti prift! Sepse ai jo vetëm është i sigurtë, po edhe sepse me të e kryejmë punën shpejt.

Prifti nuk kundërshtoi. Të huajt i morën me vete kampionet që patën zgjedhur dhe u nisën pas Xhaferrit. Xhaferri, duke i hequr këmbët zvarë, mori drejtimin për nga lugina ku qe lidhur trapi i priftit.

Oficeri që drejtonte ekspeditën i kishte kërkuar fsha-



tarit t'i tregonte ato vende ku ishin gjetur kampionet e gurëve të kromit. Xhaferri u tha se ato gjendeshin te shkëmbi i thepisur, pranë Shpellës së Valës. Prifti i përforcoi thëniet e fshatarit duke u treguar gjermanëve se në ato zona kishin bërë kërkime edhe italianët.

Trapin e mori ta drejtonte Xhaferri. Ushtarët me automatikë në duar qëndronin si galuna porti të ngrira dhe kontrollonin me kujdes lëvizjet e atij fshatari me atë fytyrë të ashpër si edhe malet përçark.

Fshatarët, kur panë se trapi nuk u lidh në bregun tjetër të Drinit, por vazhdoi udhëtimin në qetësi, bënë një lloj lëvizjeje të vrullshme që i përngjante asaj resë që sjell shtrëngatën: Gratë dhe fëmijët iu ngjitën kodrave. Së bashku me to shkoi edhe e shoqja e Xhaferrit. Burrat ndoqën gjysmë të fshehur lundrimin e ekspeditës.

Të gjithë e dinin se në atë luginë ishte i pamundur lundrimi me trap. Së shpejti do të fillonin theqafjet e lumit.

Mali i Pyllës fillonte me një kthesë, e cila ruante disi qetësinë e rrjedhës, dhe pak më tutje bëhej theqafja e parë. Planin e Xhaferrit e kuptuan të gjithë dhe u gjallëruan, por e dinin se sa në rrezik ishte edhe vetë Xhaferri. Ai duhej të shpejtonte, por nuk po ngutej. Lëvizjet e tij ishin të qeta. Të huajt ishin gjallëruar dhe qëndronin fare natyrshëm në trap. «Do të jenë fshatarë, — mendoi Xhaferi, — fshatarë dhe vrasës!» Nga mendja nuk i shqitej lebetitja e Kadries dhe e Vaidit të vogël. «Pas pak do t'i shoh si do të përpëliten këta «gjeologë» në gjirin e vdekjes. Cilin do të marrë të parin vdekja? Sigurisht atë më të vjetrin». Shikoi majat e maleve të veshura me

dushk. Pa edhe Malin e Pyllës, në faqet e të cilit kishte gjetur gurë mokre. Sa bukur ishte kjo luginë e Drinit!...

Në fshat ranë këmbanat e kishës. Dikush po i binte me tingujt e vdekjes dhe ajo tingëllimë këmbane erdhi si një sinjal zgjimi i frikshëm për të huajt. Oficeri iu afrua rremtarit dhe i kërkoi shpjegim. Xhaferri tregoi me dorë vendin ku do të ndaleshin dhe bëri sikur nuk i dëgjoi këmbanat e kishës. I huaji vetëm shtoi vigjilencën dhe nuk e zgjati më. Shihej se ato këmbana ishin dora e priftit. Ai i kishte paralajmëruar gjermanët të kishin kujdes. Por trapi pas pak do të hynte në pusin e Ingjires dhe do të binte në theqafjen e parë të lumit. Atë kohë Xhaferri, pasi të godiste ushtarin rojë ose oficerin, duhej të hidhej sa më larg në lumë.

Veprimet i bëri ashtu si i kishte menduar më parë. Hedhjen e tij në ujë e shoqëruan një sërë krismash automatiku. Kur ndjeu ftohtësinë e Drinit, zemra dhe muskujt iu lehtësuan. Në kishte shpëtuar ose jo pa marrë ndonjë plumb, nuk e dinte. Sidoqoftë ai duhej të qëndronte akoma i zhytur për të ikur sa më larg trazit. Kur nxori kokën sipër, pa trazin që përpëllitej në gjiron e pusit dhe më në fund pa dhe përplasjen e tij në shkëmb. Zhurma që vinte nga një hon i thellë nuk ishte krismë drurësh, por klithma e zërave të atyre që po shpëputeshin nga njëri-tjetri dhe nga jeta.

Xhaferri u ngjiti në bregun më të afërt dhe, si mbloodhi të gjitha fuqitë, pa se qe plagosur në dy vende. Fshatarët, që e rrethuan shpejt e shpejt, i hodhën mbi shpatulla një rrobë për ta mbrojtur nga të ftohtët.

Në këtë kohë dielli ishte ndalur në kreshtat e dallgëzuara të malit. Ujërat shkisinin gjithnjë drejt theqafjeve siç kishin shkarë shekuj e shekuj me radhë. Kadria



iu afrua Xhaferrit me atë gëzim që ndien njeriu kur e ka parë të dashurin buzë varrit dhe i është kthyer përsëri në jetë. Ndërsa i biri, Vahidi, iu var në qafë e nuk po i shqitej.

— Trimëria jote na ndriti mendjen e faqen, o njeri i urtë! — tha njëri nga burrat që qe më pranë Xhaferrit, ndërsa të tjerët tundën kokën në heshtje e në shenjë miratimi të fjalëve të të parit.

## PASQYRA E LËNDËS

Shokët .....	3
Zëri i atdheut .....	9
Tabani .....	13
Mjegulla .....	20
Nata e parë nën ujë .....	27
Në tunel .....	36
Një copëz nga jeta ime .....	41
Gurët e çmuar .....	49